

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E GJILANIT 2026 - 2031

Përmbajtja!

<u>MANUALI PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL</u>	
<u>Lista e Shkurtesave</u>	3
<u>Lista e Figurave</u>	4
<u>Lista e Tabelave</u>	5
<u>Grupi Punues</u>	6
<u>Fjalë Hyrëse nga Kryetari/ja e Komunës</u>	8
<u>I. Përmbledhja Ekzekutive</u>	9
<u>II. Hyrja</u>	10
<u>III. Metodologjia</u>	11
<u>IV. Misioni</u>	12
<u>V. Vizioni</u>	13
<u>VI. Sfondi</u>	14
<u>6.1 Analiza e gjendjes aktuale</u>	14
<u>6.2 Përkufizimi i problemit</u>	17
<u>6.3 Krahasimi me vendet/komunat të tjera</u>	17
<u>6.4 SWOT Analiza</u>	17
<u>6.5 Analiza e pemës së problemit (opcionale)</u>	18
<u>6.6 Përmbledhja e sfidave</u>	18
<u>VII. Objektivat</u>	19
<u>7.1 Objektiva e përgjithshme 1: Arsimi</u>	19
<u>7.2 Objektiva e përgjithshme 2: Infrastruktura</u>	21
<u>7.3 Objektiva e përgjithshme 3: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale</u>	22
<u>7.4 Objektiva e përgjithshme 4: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural</u>	23
<u>7.5 Objektiva e Përgjithshme 5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore</u>	25
<u>VIII. Monitorimi dhe Raportimi</u>	26
<u>IX. Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor</u>	27
<u>X. Plani i Veprimit</u>	29

Lista e shkurtesave

SZHEL - Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal

PNZHE - Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal

SZHSEL - Strategjia e Zhvillimit Socio Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit

PZHK - Planin Zhvillimor Komunal

NMV - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

AKK - Asociacioni i Komunave të Kosovës

AZHR - Agjencia për Zhvillim Rajonal-Lindje

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MZHR - Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

OJQ - Organizata Joqeveritare

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

IAAP - Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional

QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QMF - Qendra e Mjekësisë Familjare

AMF - Ambulanca e Mjekësisë Familjare

KRU - Kompania Regjionale e Ujësllësit

EF - Ekonomitë Familjare

QKB - Qendra Komunale e Biznesit

ARBK - Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural

BE - Bashkësia Evropiane

KAB - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

AP - Agjencia e Punësimit

QP & QAP - Qendra e Punësimit & Qendra për Aftësim Profesional

OE - Oda Ekonomike – Dega në Gjilan

Lista e Figurave | Grafikëve

Grafiku 1. Metodologjia

Grafiku 2. Struktura organizative e Komunës së Gjilanit

Grafiku 3. Harta e Komunës së Gjilanit

Grafiku 4. Harta e Kosovës dhe Regjioni i Gjilanit

Grafiku 5. Harta Regjioni i Gjilanit

Grafiku 6. Harta Kosova dhe korridoret 8 dhe 10

Foto 7. Liqeni Livoqit – Liqeni Akumulues – penda

Foto 8. shkolla fillore “Selami Halalqi” Gjilan

Foto 9. Liqeni Livoqit – Liqeni Akumulues – penda

Foto 10. parku “Baja” Gjilan

Foto 11. Projekti pastrimi i shtretërve te lumenjve

Lista e Tabelave

Tabela 1. Demografia e Komunës së Gjilanit

Tabela 2. Popullsia sipas viteve

Tabela 3. Numri i shkollave 2026/2027

Tabela 4. Numri i nxënësve 2026/2027

Tabela 5. Numri i nxënësve 2026/2027 | komunitetit jo shumicë

Tabela 6. Trashëgimia kulturore

Tabela 7. Buxheti 2026 – 2028

Tabela 8. Ndarja Buxhetore sipas kategorive 2026 – 2028

Tabela 9. Kufijtë Buxhetorë sipas qarkores buxhetore të vitit 2026/2028

Tabela 10. Ndikimi Buxhetor në Hartimin e Strategjisë të Zhvillimit Ekonomik Lokal

Tabela 11. Lista e projekteve të aprovuara Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)

Tabela 12. Subvencionet - Qarkorja Buxhetore për vitet 2026/2028

Tabela 13. Skema Investimet Kapitale dhe Subvencionet 2026/2028

Tabela 12. Lista e projekteve 2026 – 2031

Grupi Punues

Sipas vendimit të kryetarit, grupi punues ka përgjegjësi direkte në Hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal duke qenë pjesë e rregullt e çdo takimi të grupit punues dhe është përgjegjëse për të dhënë propozime dhe për të draftuar strategjinë. Në kuader të grupi punues kanë qene te caktuara edhe dy grupe tjera ku i dyti kishte për obligim të siguroj gjitha të dhënat e nevojshme për grupin e parë si dhe të marr pjesë në takime të përbashkëta duke kontribuar secili në fushën e vet si dhe t'i monitoroj dhe t'i aprovojë të dhënat ndërsa grupi i tretë ka patur karakter këshillëdhënës.

1. Grupi I-rë

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita dhe përshkrimi
01.	Enver Shabani	Kryesues i grupit, Drejtor për Zhvillim Ekonomik
02.	Arsim Vranovci	Anëtar, Këshillii Biznesit Rajoni i Gjilanit (GRBC)
03.	Delvina Vranovci	Anëtar, Këshillii Biznesit Rajoni i Gjilanit (GRBC)
04.	Agim Zeka	Anëtar, AZHR Lindje
05.	Valbona Tahiri	Anëtar, AZHR Lindje
06.	Gzim Tosuni	Anëtar, Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan
07.	Shqiprim Ahmeti	Anëtar, Universiteti i UBT-së
08.	Shpresim Vranovci	Anëtar, Universiteti i UBT-së
09.	Berat Mustafa	Anëtar, Fluidi Group
10.	Milivoje Zhivkovic	Anëtar, Zyra për Kthim dhe Komunitete
11.	Ilirjana Uruqi	Anëtar, Kryesuese e Komitetit të DZHE
12.	Besnik Shala	Anëtar, Lëvizja Vetëvendosje
13.	Hekuran Kryeziu	Anëtar, Lëvizja Vatra
14.	Fadil Sherifi	Anëtar, AKR
15.	Erestina Isufi	Anëtar, PDK
16.	Erleta Halimi	Anëtare, Oda Ekonomike – njësia në Gjilan
17.	Fahrush Morina	Anëtar, Qendra Rajonale e Punësimit
18.	Nentor Shaqiri	Anëtar-Zyra e Kryetarit
19.	Shqiprim Zeqiri	Anëtar, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
20.	Besart Selimi	Anëtar-Zyra e Kryetarit
21.	Azem Mujku	Anëtar, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
22.	Fadil Osmani	Anëtar, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
23.	Arjeta Maka	Anëtar, Shoqëria Civile
25.	Muhamet Halili	Anëtar, Shoqëria Civile - Media
26.	Jetm Jeriu	Anëtar, Drejtoria e Arsimit
27.	Sali Rexhepi	Anëtar, Instituti për Demokratizim dhe Avokim

2. Grupi II-të

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita dhe përshkrimi
01.	Ali Arifi	Anëtar, Drejtor i Urbanizmit
02.	Shpend Nuhiu	Anëtar, Drejtor e Arsimit
03.	Herolinda Murati Leka	Anëtar, Drejtor e Buxhetit dhe Financave
04.	Kushtrim Ibrahim	Anëtar, Drejtor e Shërbimeve Publike
05.	Doruntina Hasani	Anëtar, Drejtor e Shëndetësisë
06.	Arbenita Sopi – Haziri	Anëtar, Drejtor e Administratës së Përgjithshme
07.	Kushtrim Zeqiri	Anëtar, Drejtor e Kulturës
08.	Bekim Salihu	Anëtar, Drejtor e Kadastrit
09.	Kujtim Bajrami	Anëtar, Departamenti i Prokurimit
10.	Entela Hyseni	Anëtar, Drejtor e Inspeksionit
11.	Bajram Isufi	Anëtar, Drejtor e Bujqësisë
12.	Nefail Haziri	Anëtar, Qendra për Aftësim Profesional
13.	Elhami Idrizi	Anëtar, Oda Hotelerisë – njësia në Gjiçan
14.	Fetah Jeriu	Anëtar, Drejtor e Arsimit
15.	Elhami Idrizi	Anëtar, Oda Hotelerisë – njësia në Gjiçan

3. Grupi III-të

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita dhe përshkrimi
01.	Bafti Dogani	Anëtar, Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal
02.	Qefser Bajrami	Anëtar, Ministria e Zhvillimit Rajonal

Kontribues shtesë në hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita dhe përshkrimi
01.	Haki Huruglica	Kryesues i grupit, Drejtor për Zhvillim Ekonomik
02.	Flakron Rexhepi	Anëtar, Drejtor i Urbanizmit
03.	Jeton Rexhepi	Anëtar, Drejtor e Arsimit
04.	Abdyl Kastrati	Anëtar, Drejtor e Buxhetit dhe Financave
05.	Kushtrim Ibrahim	Anëtar, Drejtor e Shërbimeve Publike
06.	Mimoza Kadriu	Anëtar, Drejtor e Shëndetësisë
07.	Elbasan Shbani	Anëtar, Drejtor e Administratës së Përgjithshme
08.	Kushtrim Zeqiri	Anëtar, Drejtor e Kulturës
09.	Eljesë Rashiti	Anëtar, Drejtor e Kadastrit
10.	Isa Agushi	Anëtar, Drejtor e Inspeksionit
11.	Bajram Isufi	Anëtar, Drejtor e Bujqësisë
12.	Fetije Begolli	Anëtar, Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal
13.	Jetmir Jerliu	Anëtar, Drejtor e Arsimit
14.	Petrit Vokshi	Anëtar, Qendra Rajonale e Punësimit

FJALIA HYRËSE NGA KRYETARI I KOMUNËS



Të nderuar qytetarë,

Me kënaqësi po ju prezantojmë Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026 - 2031.

Ky dokument ka për qëllim të rikthej vëmendjen drejt objektivave afatgjatë, të cilët do të mund të garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm të Komunës së Gjilanit në të ardhmen.

Kjo strategji është hartuar përmes një procesi të gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi me përfaqësues të sektorit publik, sektorit privat, shoqërisë civile dhe, në mënyrë të veçantë, me komunitetin e biznesit.

Ky dokument është më shumë se një plan; ai përfaqëson një vizion të përbashkët të institucioneve, biznesit dhe shoqërisë civile për një të ardhme më të zhvilluar dhe më të mirë për të gjithë qytetarët tanë, pa dallim.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal shpalos perspektiva të reja për komunën, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik. Në këtë drejtim, zhvillimi i Parkut Industrial në Gjilan paraqet një hap strategjik drejt krijimit të një zone moderne ekonomike, e cila do të fuqizojë klimën e investimeve, do të nxisë zhvillimin industrial, do të krijojë vende të reja pune dhe do ta pozicionojë Gjilanin si një qendër të rëndësishme të zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Me krenari pohojmë se kjo Strategji e Zhvillimit do të jetë një udhërrëfyes për Komunën e Gjilanit, duke orientuar dhe nxitur përpjekjet tona të vazhdueshme drejt realizimit të objektivave të përbashkëta dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Faleminderit për besimin dhe përkushtimin tuaj në këtë rrugëtim të përbashkët.

I juaji,
Alban Hyseni, Kryetar
Komuna e Gjilanit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit i referohet periudhës 2026-2031 dhe është një dokument strategjik i pavarur që synon zhvillimin ekonomik lokal të komunës, dhe është për gatitur nga Drejtoritë komunale në bashkëpunim me përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile.

Dokumenti i strategjisë përmban kapitujt kryesor si: profili analitik i cili na informon me zhvillimin aktual dhe çështjet kryesore të komunes së Gjilanit; kapitulli tjetër përshkruan vizionin e ardhshëm të komunes, qëllimet dhe objektivat strategjik dhe lidhjen ndërmjet tyre si dhe kapitulli i tretë, portofoli i projekteve, shtjellon projekte konkrete të zbatueshme që shkojnë në funksion të realizimit të qëllimeve dhe objektivave të strategjisë në afatin e shkurtër dhe të mesëm në fushat me potencial për ndikim në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal.

Për periudhën që mbulon ky dokument strategjik, vizioni i Komunës së Gjilanit synon zhvillimin e metejshëm të infrastrukturës, nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të metejshëm të bujqësisë, si një vend atraktiv për investitorët vendor dhe të huaj për hapjen e bizneseve të reja që do të çojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbajtjen e të rinjeve, nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm sipas nevojave të tregut të punës, zhvillimit të turizmit nëpërmjet shfrytëzimit dhe promovimit të trashëgimisë sonë kulturore, historike dhe natyrore dhe më e rëndësishmja të krijohet një ambient më i favorshëm për të bërë biznes duke ndikuar kështu në ngritjen e standardit jetësor të qytetarëve të komunes sone.

Duke bërë analizën SWOT ne përcaktuam se çfarë duhet të përdoret dhe të vihet maksimalisht në funksion të zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Gjilanit si: tokë pjellore dhe bujqësi e zhvilluar, vendndodhje e mirë gjeografike dhe burime të cilat i kemi dhe që janë vendimtare jo vetëm për komunën tonë, por në përgjithësi dhe për rajonin.

Mangësitë më të mëdha të Komunes së Gjilanit janë migrimi i të rinjeve si problemi më i madh me të cilin po përballemi në të gjithë vendin, jo vetëm këtu, pastaj ndotja e ambientit, infrastruktura e paperfunduar dhe problemet urbane për të cilat duhet të punohet ndjeshëm në periudhën e përputhje me strategjinë

I. Hyrja

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026–2031 është një dokument strategjik që përcakton vizionin, objektivat dhe prioritetet për zhvillimin ekonomik të Komunës së Gjilanit gjatë periudhës 2026–2031. Qëllimi i saj është krijimi i një mjedisi të favorshëm për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë lokale, përmirësimin e klimës së biznesit dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Procesi i hartimit të strategjisë është zhvilluar në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke angazhuar institucionet komunale, komunitetin e biznesit, organizatat e shoqërisë civile, institucionet akademike, mediat, përfaqësues të ministrive përkatëse, si dhe partnerë të tjerë zhvillimorë. Ky proces ka mundësuar identifikimin e prioriteteve zhvillimore dhe përcaktimin e masave që adresojnë nevojat reale të komunitetit dhe ekonomisë lokale.

Strategjia është hartuar në përputhje me dokumentin udhëzues të Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL), është bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe është harmonizuar me Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal (PNZHEL) 2030.

Në përputhje me vizionin dhe prioritetet e PNZHEL 2030, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026–2031 fokusohet në objektivat dhe masat për të cilat Komuna e Gjilanit ka kompetenca të drejtpërdrejta ose kompetenca të përbashkëta me institucionet qendrore. Në këtë kuadër, strategjia mbështetet në këto objektiva strategjike:

1. **Rritja e investimeve dhe zhvillimi i ekonomisë lokale konkurruese**, përmes promovimit të potencialeve ekonomike të komunës, përkrahjes së ndërmarrësisë, inovacionit dhe tërheqjes së investimeve.
2. **Zhvillimi i bujqësisë, turizmit dhe ekonomisë rurale**, përmes rritjes së produktivitetit, mbështetjes së fermerëve, zhvillimit të zinxhirit të vlerës dhe promovimit të potencialeve turistike të komunës.
3. **Rritja e punësimit dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor**, përmes fuqizimit të aftësive profesionale, mbështetjes së grave, të rinjve dhe grupeve të tjera prioritare, si dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me sektorin privat.
4. **Përmirësimi i infrastrukturës dhe mjedisit për zhvillim ekonomik lokal**, përmes investimeve në infrastrukturën komunale, menaxhimin e mbeturinave, eficiencën e energjisë dhe krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e biznesit.

5. **Forcimi i qeverisjes lokale, financave komunale dhe partneriteteve për zhvillim ekonomik**, përmes përmirësimit të planifikimit strategjik, digjitalizimit të shërbimeve komunale, rritjes së kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimit me sektorin privat, shoqërinë civile, donatorët dhe institucionet qendrore.

Përveç Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, gjatë hartimit të kësaj strategjie janë marrë në konsideratë dokumente të rëndësishme strategjike dhe planifikuese në nivel lokal dhe kombëtar, të cilat sigurojnë harmonizimin e prioriteteve zhvillimore dhe zbatimin e politikave publike. Këto dokumente përfshijnë:

1. Strategjinë për Zhvillim Socio-Ekonomik 2017–2021;
2. Strategjinë për Gratë në Ndërmarrësi 2017–2021;
3. Planin Zhvillimor Komunal (në proces të rishikimit);
4. Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023–2027;
5. Planin për Eficiencën e Energjisë dhe Klimën 2022–2030;
6. Ligjin e Buxhetit dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028.

Këto dokumente kanë shërbyer si bazë për identifikimin e prioriteteve zhvillimore dhe për përcaktimin e objektivave strategjike të kësaj strategjie, duke siguruar përputhshmëri me politikat kombëtare dhe praktikat bashkëkohore të zhvillimit ekonomik lokal.

Fokusi i Strategjisë është krijimi i një ekonomie lokale më konkurruese dhe më të qëndrueshme, përmes përmirësimit të klimës së biznesit, rritjes së investimeve publike dhe private, zhvillimit të ndërmarrësisë, bujqësisë dhe turizmit, avancimit të infrastrukturës ekonomike dhe komunale, zhvillimit të kapitalit njerëzor, promovimit të inovacionit dhe digjitalizimit, mbrojtjes së mjedisit, si dhe forcimit të partneritetit ndërmjet sektorit publik, sektorit privat, shoqërisë civile dhe komunitetit.

Strategjia njih gjithashtu rolin e rëndësishëm të diasporës si një partner strategjik në zhvillimin ekonomik lokal. Përmes investimeve, transferimit të njohurive, përvojës profesionale dhe rrjeteve ndërkombëtare, diaspora përbën një potencial të rëndësishëm për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë lokale dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim.

Në përfundim, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026–2031 synon të krijojë një bazë të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik të Komunës së Gjilanit, duke kontribuar në rritjen e punësimit, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, rritjen e investimeve dhe zhvillimin e një ekonomie lokale konkurruese, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, në përputhje me prioritetet e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030.

II. Metodologjia


Gjatë përgatitjes së kësaj strategjie, është aplikuar metodologjia e parashikuar në “Udhëzuesin për Hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal” nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal . Me Vendim të Kryetarit të Komunës, z. Alban Hyseni, me nr. të protokollit 163, datë 30.01.2024, është hapur procesi i hartimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026–2031, dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik është caktuar si bartëse e këtij procesi.

Grupi Punues, i përbërë nga zyrtarë komunalë nga të gjitha drejtoritë komunale, përfaqësues të komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe ministrive relevante, ka kontribuar në hartimin e strategjisë përmes pesë takimeve me drejtoritë komunale dhe katër punëtorive të realizuara me pjesëmarrje aktive të Grupit Punues. Këto aktivitete janë mbështetur financiarisht nga OSBE.

Për këtë dokument strategjik janë shfrytëzuar të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe nga institucione të tjera relevante, përfshirë rezultatet e një ankete të realizuar me bizneset në Komunën e Gjilanit, e organizuar nga Këshilli i Bizneseve të Rajonit të Gjilanit (GRBC).

Po ashtu, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka mbajtur një dëgjese publike, ku janë marrë parasysh sugjerimet nga palët e interesit, të cilat kanë qenë të rëndësishme për finalizimin e këtij dokumenti thelbësor për Komunën e Gjilanit.

Grafiku : Metodologjia



III. Misioni

Të krijojmë një ambient të favorshëm për zhvillim të qendrueshem ekonomik lokal dhe mirëqenie sociale duke balancuar dhe shfrytëzuar resurset lokale, promovimi i ndërmarresise dhe inovacionit dhe të permiresojme cilësinë e jetës për të gjithë qytetaret e Gjilanit.

IV. Vizioni

"Gjilani, një qendër ekonomike, kulturore dhe inovative, ku buzëqeshja dhe prosperiteti lulëzojnë për të gjithë banorët dhe regionin e Anamoravës, duke respektuar dhe kultivuar vlerat e gjeneratave të kaluara"

6.1 Analiza e gjendjes aktuale

Komuna e Gjilanit shtrihet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës, në rajonin e Anamoravës, dhe ka një sipërfaqe prej **392 km²**. Qendra urbane ndodhet në një lartësi mbidetare prej rreth **501–590 metra**, ndërsa territori i komunës shtrihet nga rreth **475 metra** në zonën e Budrikës deri në afro **1,000 metra** mbi nivelin e detit në zonën kufitare të Stançiqit. Pozita gjeografike, relievi dhe kushtet natyrore i japin komunës potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, bujqësore, turistike dhe rekreative.

Gjilani është qendra administrative, ekonomike dhe institucionale e rajonit të Anamoravës. Komuna kufizohet me komunat e Parteshit, Ranillugut, Novobërdës dhe Vitisë, ndërsa në lindje dhe juglindje ndodhet në afërsi të kufirit me Republikën e Serbisë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo pozitë e vendos Gjilanin në një zonë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin ndërkufitar, zhvillimin e tregtisë dhe nxitjen e investimeve.



Një nga përparësitë më të rëndësishme konkurruese të Komunës së Gjilanit është **pozita e saj gjeostrategjike në rrjetin rajonal të transportit**. Komuna lidhet me kryeqytetin Prishtinë përmes rrugës nacionale dhe autostradës **Gjilan–Prishtinë**, e cila është në fazën përfundimtare të ndërtimit dhe pritet të shkurtojë ndjeshëm kohën e udhëtimit dhe të përmirësojë qasjen në tregjet vendore dhe ndërkombëtare.

Përmes akseve rrugore **Gjilan–Prishtinë**, **Gjilan–Shkup** dhe **Gjilan–Bujanoc**, komuna krijon lidhje funksionale me dy korridore të rëndësishme panevropiane të transportit:

- **Korridorin VIII**, që lidh Detin Adriatik me Detin e Zi përmes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë;
- **Korridorin X**, që lidh Evropën Qendrore me Evropën Juglindore, duke kaluar përmes Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë.

Këto lidhje e pozicionojnë Gjilanin si një pikë me potencial të rëndësishëm për zhvillimin e logjistikës, tregtisë, industrisë, investimeve dhe bashkëpunimit ekonomik rajonal.



Figura 6.1. Pozita gjeostrategjike e Komunës së Gjilanit në raport me Korridorin VIII dhe Korridorin X.

Në aspektin e qasjes në infrastrukturën rajonale, Gjilani ndodhet rreth **60 km** nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" dhe rreth **86 km** nga Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit. Porti i Durrësit ndodhet rreth **320 km**, ndërsa Porti i Shëngjinit rreth **290 km** larg. Stacionet më të afërta hekurudhore janë në **Ferizaj (33 km)** dhe **Bujanoc (41 km)**. Këto lidhje krijojnë mundësi të favorshme për zhvillimin e tregtisë, transportit të mallrave dhe integrimin e ekonomisë lokale në tregjet rajonale.

Komuna e Gjilanit karakterizohet gjithashtu nga burime të rëndësishme natyrore. Nëpër territorin e saj kalon lumi **Morava e Binçës**, i cili buron në Malet e Karadakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe përbën një nga burimet kryesore ujore të rajonit.

Në territorin e komunës ndodhen dy liqene akumuluese me rëndësi strategjike. **Liqeni i Përlepnicës**, me kapacitet rreth **5 milionë m³**, shërben si burim kryesor për furnizimin me ujë të pijshëm, ndërsa **Liqeni i Livoçit**, i vendosur rreth **4 km** nga qendra e qytetit, paraqet potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit rekreativ, sporteve ujore dhe aktiviteteve të tjera ekonomike të lidhura me turizmin.

Komuna disponon gjithashtu burime të ujërave termale në **Uglar** dhe **Dobërçan**, të cilat përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit shëndetësor dhe investimeve në sektorin e mirëqenies dhe rekreacionit.

Përveç burimeve ujore, territori i komunës është i pasur edhe me resurse minerale dhe materiale ndërtimore, ndërsa në lokalitetet **Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglar dhe Përlepnicë** identifikohen burime minerale që paraqesin potencial për zhvillim ekonomik, në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Në tërësi, pozita gjeografike, lidhjet me korridoret ndërkombëtare të transportit, infrastruktura rrugore në zhvillim dhe pasuritë natyrore e vendosin Komunën e Gjilanit në një pozitë të favorshme për zhvillimin e sektorit privat, tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja, zhvillimin e turizmit, rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026–2031.

Demografia

Analiza demografike e Komunës së Gjilanit në këtë strategji bazohet në të dhënat zyrtare të **Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024**, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Të dhënat nga regjistrimet e mëparshme janë përdorur vetëm për qëllime krahasuese, me qëllim të evidentimit të ndryshimeve demografike ndër vite.

Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024, Komuna e Gjilanit ka **82,901 banorë**, prej të cilëve **41,708 (50.31%) janë meshkuj**, ndërsa **41,193 (49.69%) janë femra**. Mosha mesatare e popullsisë është rreth **34 vjeç**, çka tregon tendencën e plakjes graduale të popullsisë krahasuar me regjistrimin e vitit 2011.

Viti	Gjithsej banorë	Meshkuj	%	Femra	%
2011	90,178	45,354	50.29	44,824	49.71
2024	82,901	41,708	50.31	41,193	49.69

Krahasuar me regjistrimin e vitit 2011, numri i banorëve në Komunën e Gjilanit është zvogëluar për **7,277 banorë**. Megjithatë, struktura gjinore e popullsisë ka mbetur pothuajse e pandryshuar, duke ruajtur një raport të balancuar ndërmjet meshkujve dhe femrave.

Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024, në Komunën e Gjilanit janë regjistruar:


- **19,489 ekonomi familjare;**
- madhësia mesatare e ekonomisë familjare është **4.3 anëtarë;**
- **32,676 banesa**, prej të cilave **19,924 (61%) janë të banuara**, ndërsa **12,752 (39%) janë të pabanuara**.

Analiza e zhvillimeve demografike tregon se Komuna e Gjilanit, ngjashëm me komunat e tjera të Kosovës, është përballur me ndryshime të rëndësishme të strukturës së popullsisë, të ndikuara nga migrimi i brendshëm dhe i jashtëm, ndryshimet në shtimin natyror të popullsisë, si dhe ndryshimet administrative territoriale. Në veçanti, pas vitit 1999 është vërejtur një zhvendosje e popullsisë nga zonat rurale drejt qendrës urbane, ndërsa emigrimi jashtë vendit ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të përgjithshëm të banorëve.

Për të analizuar trendet demografike afatgjata, në strategji paraqiten edhe të dhënat krahasuese të regjistrimeve të mëparshme të popullsisë (1948–2011), të cilat shërbejnë vetëm për të ilustruar evolucionin demografik të komunës dhe nuk përbëjnë bazën statistikore të kësaj strategjie.

Gjilani

Viti	Nr.banoreve
1948	41,914
1953	45,581
1961	53,476
1971	67,893
1981	84,685
1991	110,464
2011	90,178
2024	82,901




Rënia e numrit të banorëve lidhet me një sërë faktorësh, përfshirë migrimin e brendshëm dhe të jashtëm, ndryshimet në shtimin natyror të popullsisë, si dhe ndryshimet administrative territoriale që kanë ndikuar në numrin e përgjithshëm të banorëve të komunës.

6.2 Struktura dhe funksionimi i Komunës së Gjilanit

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040, Komuna ka gjithsej 12 drejtori të cilat janë prezantuar detajisht te struktura organizative e komunës ne grafikonin me larte dhe është përgjegjëse për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve.

Struktura organizative e Komunës së Gjilanit



Struktura organizative e Komunës së Gjilanit mundëson ofrimin e shërbimeve efikase dhe cilësore për qytetarët, përmes koordinimit të drejtorive dhe njësive administrative.

Aktualisht, administrata komunale është e shpërndarë në disa objekte, gjë që ka paraqitur sfida në qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve dhe në koordinimin institucional.

Me ndërtimin e objektit të ri të administratës komunale, shumica e shërbimeve do të përqendrohen në një lokacion të vetëm, duke lehtësuar qasjen e qytetarëve, duke rritur efikasitetin e punës administrative dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike.

Administrata

Sipas të dhënave të siguruara nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit për vitin 2026 (gjendja e tanishme) , komuna ka gjithsej 287 të punësuar, të shpërndarë sipas kategorive, gradave, gjinisë, grupmoshave dhe nivelit të arsimit.

Struktura e të punësuarve sipas kategorive :

- Nëpunës të shërbimit civil – **228**
- Nëpunës të shërbimit publik – **17**
- Krijues dhe performues të artit dhe kulturës – **20**
- Nëpunës teknikë dhe mbështetës – **11**
- Zyrtarë të kabinetit (funksionarë publikë) – **11**

Struktura sipas gradave

- Nëpunës të kabinetit – **11**
- Drejtues të ulët – **26**
- Profesionalë – **185**
- Specialistë – **23**
- Nëpunës të shërbimit publik – **11**
- Krijues dhe performues të artit dhe kulturës – **20**
- Nëpunës teknikë dhe mbështetës – **11**

Struktura sipas gjinisë

- Femra – **120** (41.8%)
- Meshkuj – **167** (58.2%)

Struktura sipas grupmoshave

- 26–35 vjeç – **33**
- 36–45 vjeç – **84**
- 46–55 vjeç – **77**
- 56–60 vjeç – **54**
- 61–65 vjeç – **39**

Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e stafit i përket grupmoshave 36–55 vjeç, çka reflekton një administratë me përvojë profesionale.

Struktura sipas nivelit të arsimit

- Arsim superior – **219** (76.3%)
- Arsim i mesëm – **68** (23.7%)

Përqindja e lartë e të punësuarve me arsim superior tregon një nivel të mirë të kapaciteteve profesionale dhe administrative në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

Arsimi

Arsimi ka një vemendje të konsiderueshme në komunën e Gjilanit derisa aktivisht është duke u punuar në ngritjen e cilësisë në arsim, po ashtu prioritet është duke ju dhënë shkollave profesionale, duke i përshtatur profilet me nevojat e tregut të punës.

Arsimi para fillor, fillor dhe i mesëm është një nga segmentet kyçe, ka pasur një rritje në investime për të siguruar që të gjitha shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm kanë infrastrukturën dhe resurset e nevojshme për të ofruar një arsim cilësor.

Po ashtu edhe sa i përket shtrirjes së arsimit fillor dhe të mesëm ofrojnë arsim në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe rome.

Në nivelin, parashkollor, fillor dhe të mesëm, ka një varietet institucionesh arsimore, duke përfshirë shkolla të ndryshme të mesme publike dhe private, dhe shkolla profesionale.

Megjithatë, edhe pse ka pasur përparime, ka ende sfida në sistemin arsimor, përfshirë nivelin e ulët të cilësisë së arsimit, Drejtoria e Arsimit po punon ngushtë me të gjithë akteret duke përfshirë Qeverinë e Kosovës dhe komunitetin ndërkombëtarë për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar sistemin arsimor në tërësi.



Foto : shkolla fillore "Selami Hallaqi" Gjilan

Komuna e Gjilanit ka krijuar kushte për të gjitha komuniteti sa i përket sektorit të arsimit, kjo do të ketë ndikim pozitive nga se kjo ndihmojë në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë.

Viti shkollor 2025/2026

Infrastruktura shkollore në komunën e Gjilanit paraqitet përgjithësisht në gjendje të mirë, me shumicën dërrmuese të objekteve funksionale dhe të mirëmbajtura.

Pothuajse të gjitha shkollat janë të lidhura me rrjetin publik të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërsa një numër i vogël shfrytëzon puse ose gropa septike.

Ngrohja sigurohet kryesisht me dru, pelet dhe energji elektrike, me përdorim më të kufizuar të naftës. Një pjesë e shkollave janë të pajisura me salla të edukatës fizike, si dhe disa kanë filluar të aplikojnë masa për kursim të energjisë dhe sisteme solare. Në tërësi, infrastruktura plotëson kushtet bazë për zhvillimin e procesit mësimor.

Të gjitha të dhënat e përdorura janë siguruar nga Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA), i administruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës.

NR. OBJEKTEVE	NUMRI I OBJEKTEVE SHOLLAVE NË NIVELIN PARAUNIVERSITAR / ISCED 0-3 - GJILAN	NIVELI
1	Institucioni Parashkollor "Ardhmëria I"	0-1
2	Institucioni Parashkollor "Ardhmëria II"	0-1
3	Institucioni Parashkollor "Integji"	0-1
4	Institucioni Parashkollor "Dardania"	0-1
5	Institucioni Parashkollor Dobërçan	0-1
6	Institucioni Parashkollor Zhegër	0-1
7	Shkolla "Selami Hallaqi"	1&2
8	Shkolla "Abaz Ajeti"	1&2
9	Shkolla "Thimi Mitko"	1&2
10	"Shkolla "Musa Zajmi"	1&2
11	Shkolla "Zija Shemsiu"	1&2
12	Shkolla "Rexhep Elmazi"	1&2
13	Shkolla "Nazmi Hoxha"	1&2
14	Shkolla "Dëshmorët e Kombit"	1&2
15	Shkolla "Ramiz Cërnica"	1&2
16	Shkolla "Ramiz Cërnica" – paralelja Gumnishtë	1
17	Shkolla "Ramiz Cërnica" paralelja Kravaricë	1&2
18	Shkolla "Agim Ramadani"	1&2

19	Shkolla "Agim Ramadani" paralelja Haxhaj	1
20	Shkolla "Agim Ramadani" paralelja Selishtë	1
21	Shkolla "Agim Ramadani" paralelja Lladovë	1
22	Shkolla "Agim Ramadani" paralelja Nasalë	1
23	Shkolla "Bajram Curri"	1&2
24	Shkolla "Esat Berisha"	1&2
25	Shkolla "Mulla Idriz Gjilani"	1&2
26	Shkolla "Abdullah Tahiri"	1&2
27	Shkolla "Vehbi Ibrahimiri"	1&2
28	Shkolla "Liria"	1&2
29	Shkolla "Liria" paralelja Llovcë	1
30	Shkolla "Liria" paralelja Bilinicë	1
31	Shkolla "Nazim Hikmet"	1
32	Shkolla "Nazim Hikmet" paralelja Bukovik	1&2
33	Shkolla "Skenderbeu"	1&2
34	Shkolla "Skenderbeu" paralelja Kmetovc	1
35	Shkolla "Skenderbeu" paralja Verbic e Kmetovc	1
36	Shkolla "Vatra e Diturisë"	1&2
37	Shkolla "Ibrahim Uruqi"	1&2
38	Shkolla "Vesel Muja"	1&2
39	Shkolla "Vesel Muja" paralelja Ponesh	1&2
40	Shkolla "Afërdita"	1&2
41	Shkolla "Afërdita" paralelja Gadish	1&2
42	Shkolla "Afërdita" paralelja Sllakovc	1&2
43	Shkolla "Fetah Qerimi"	1&2
44	Shkolla "Fetah Qerimi" paralelja Zhegoc	1&2
45	Shkolla "Sadulla Brestovci"	1&2
46	Gjimnazi Shoqëror "Zenel Hajdini"	3
47	Gjimnazi Natyror "Xhavit Ahmeti"	3
48	Shkolla "Mehmet Isai"	3
49	Shkolla "Marin Barleti"	3
50	Shkolla "Marin Barleti" paralelja Zhegër	3
51	Shkolla "Sahit Baftiu"	3
52	Shkolla e Mesme e Muzikës	3
53	Shkolla & IP "Kosovski Božur"	0-1
54	Shkolla "Vuk Karagjigj" Gjilan	1&2
55	Shkolla "Vuk Karagjigj" Kmetoc	1&2
56	Shkolla "Vuk Karagjigj" – Gimnazi & Mjekësia Shillovë	1,2&3
57	Shkolla "Branko Radiceviq" Čerñicë	1&2
58	Shkolla "Sveti Sava" Ponesh	1&2
Gjithsej numri i objekteve të shkollave në Komunën e Gjilanit		58

Analiza e të dhënave sipas gjinisë – Grup Mosha!

Emri i shkollës	Grup Mosha 1-2			Grup Mosha 3-4			Grup Mosha 4-5		
	Mashkull	Femër	Gjithsej	Mashkull	Femër	Gjithsej	Mashkull	Femër	Gjithsej
Abaz Ajeti	0	0	0	0	0	0	10	7	17
Lagja e VIII	0	0	0	6	3	9	0	0	0
Dëshmorët e Kombit	0	0	0	0	0	0	10	10	20
Agim Ramadani	5	6	11	10	9	19	10	11	21
Mulla Idriz Gjilani	0	0	0	7	14	21	0	0	0
Nazim Hikmet	0	0	0	10	8	18	0	0	0
Skenderbeu	0	0	0	0	0	0	3	12	15
Vatra e Diturisë	0	0	0	0	0	0	15	20	35
Gjithsej	5	6	11	33	34	67	48	60	108

Analiza e të dhënave sipas gjinisë – Grup Mosha 5-6

Përshkrimi	Grupa 5-6 / parafillor		
	Mashkull	Femër	Gjithsej
Gjithsej	469	400	869

Analiza e të dhënave sipas klasave

Klasa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Gjithsej
Gjithsej	1,179	1,034	1,076	1,039	1,114	1,095	1,017	1,124	984	9,662

Analiza e të dhënave sipas klasave!

Emërtimet	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
Gjithsej	1,181	1,139	1,087

Komuniteti Serb dhe Rom | sektori i Arsimit

Komuniteti serb dhe rom janë pjesë integrale e zhvillimit shoqëror dhe arsimor në komunën e Gjilanit, duke kontribuar në diversitetin kulturor dhe në pasurimin e jetës institucionale.

Në sektorin e arsimit, për komunitetin serb të dhënat vazhdojnë të raportohen sipas sistemit të vjetër arsimor, i cili përfshin arsimin parashkollor, arsimin fillor (klasat 1–8) dhe arsimin e mesëm (klasat 1–4).

Ndërkohë, komunitetet turke është pjesë aktive në sistemin arsimor të integruar, duke ndikuar në ndërtimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe shumëgjuhësor në shkollat e komunës.

Numri i nxënësve të IEA-ve SHFMU komuniteti serb dhe rom viti shkollor 2025/2026

Nr	SHFMU	Gjinia	0	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	I-IV	V-VIII	Total
1	Vuk Karagjic Shillovë	M	7	10	7	10	10	17	9	10	3	37	39	83
		F	6	8	5	8	9	9	7	6	5	30	27	63
		Gj	13	18	12	18	19	26	16	16	8	67	66	146
	Vuk Karagjic Kmetoc	M	1	1	0	1	0	1	1	2	2	2	6	9
		F	0	0	1	0	3	0	0	1	0	4	1	5
		Gj	1	1	1	1	3	1	1	3	2	6	7	14
	Gjithsej	M	8	11	7	11	10	18	10	12	5	39	45	92
		F	6	8	6	8	12	9	7	7	5	34	28	68
		Gj	14	19	13	19	22	27	17	19	10	73	73	160
2	Vuk Karagjic Gjilan	M	0	1	1	0	0	3	1	1	0	2	5	7
		F	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	2	2
		Gj	0	1	1	0	0	3	1	2	1	2	7	9
	Vuk Karagjic Romët	M	5	2	1	6	4	5	2	5	4	13	16	34
		F	4	6	6	4	2	6	6	1	5	18	18	40
		Gj	9	8	7	10	6	11	8	6	9	31	34	74
	Gjithsej	M	5	3	2	6	4	8	3	6	4	15	21	41
		F	4	6	6	4	2	6	6	2	6	18	20	42
		Gj	9	9	8	10	6	14	9	8	10	33	41	83
3	Sveti Sava Ponesh	M	2	1	3	2	0	0	1	2	0	6	3	11
		F	0	0	1	0	0	1	0	0	2	1	3	4
		Gj	2	1	4	2	0	1	1	2	2	7	6	15
4	Branko Radicevic Cërrnicë	M	1	1		2				1	2	3	3	7
		F			1		1	1	1	2		2	4	6
		Gj	1	1	1	2	1	1	1	3	2	5	7	13
	Gjithsej	M	3	2	3	4	0	0	1	3	2	9	6	18
		F	0	0	2	0	1	2	1	2	2	3	7	10
		Gj	3	2	5	4	1	2	2	5	4	12	13	28

Numri i nxënësve të IEA-ve SHFMU komuniteti serb dhe rom viti shkollor 2025/2026

Gjinia Meshkuj : 151

Gjinia Femra : 120

Gjithsej : 271

Numri i nxënësve të IEA-ve SHML komuniteti serb viti shkollor 2025/2026

Gjimnazi - gjinia meshkuj dhe femra : 80

Mjekësia – gjinia meshkuj dhe femra : 110

Gjithsejt | Komuniteti Serb dhe Rom | sektori i Arsimit

Institucionet Parashkollore dhe Mosha 6 vite : 30

IEA-ve SHFMU - shkollat fillore: 271

IEA-ve SHML – shkollat e mesme: 190

Gjithsejt : 491

Disponimi i kabineteve shkencore dhe hulumtuese në shkolla:

Kabinete, laborator, punëtori: 18

Numri i objekteve shkollore me klasa të pajisura me mjete elektronike: 29

Në komunën e Gjilanit funksionojnë dy shkolla private që pasurojnë mozaikun arsimor:
Shkolla “Hello Academy of Education” dhe

Qendra Sociale-Edukative “Don Bosko”

Struktura e stafit dhe përgatitja arsimore në institucionet arsimore të Gjilanit

Të dhëna tregojnë për një strukturë me nivel të kënaqshëm të kualifikimit, veçanërisht në segmentin akademik, në përputhje me kërkesat e sistemit arsimor.

Në total janë të angazhuar 1765 punonjës, të shpërndarë në tri nivele kryesore: 1212 në SHFMU, 396 në SHML dhe 157 në IEA, çka tregon për përqendrim më të madh të stafit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.

Brenda kësaj strukture dominon stafi akademik (mësimdhënës dhe edukatorë), ndërsa pjesë përbërëse janë edhe stafi administrativ dhe teknik.

Sa i përket përgatitjes arsimore, pjesa më e madhe e stafit posedon Bachelor 4-vjeçar, një numër i konsiderueshëm ka përfunduar Master, duke dëshmuar për një nivel të mirë profesionalizmi.

Një numër më i vogël ka kualifikime të tjera si Bachelor 3-vjeçar, ndërsa kemi punonjës që kanë gradën Doktoraturë. Në anën tjetër, stafi mbështetës (si pastrues, rojtarë dhe mirëmbajtës) kryesisht ka të përfunduar arsim fillor dhe arsim të mesëm

Komuna e Gjilanit ofron kushte të qëndrueshme dhe të zhvilluara për procesin edukativo-arsimor, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës shkollore, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve në sistemin arsimor.

Përmes investimeve të vazhdueshme në objekte shkollore, staf profesional dhe kushte mësimore, komuna po kontribuon në krijimin e një ambienti të sigurt dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në të gjitha nivelet e arsimit.

Sipas të dhënave të paraqitura:

- Numri total i nxënësve:
 - Arsimi fillor: 9662 nxënës
 - Arsimi i mesëm: 3302 nxënës
 - Arsimi parafillor: 869 nxënës

Në total, në komunën e Gjilanit janë 58 shkolla me rreth 13,833 nxënës, të cilët përfshihen në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke reflektuar një sistem arsimor të organizuar dhe funksional.

Në qytetin e Gjilanit funksionon Universiteti Publik “Kadri Zeka” i cili ofron këto programe studimi Bachelor : Fakulteti i Edukimit, Juridik, Shkenca Kompjuterike, Shkncë Aplikative si dhe Master ne: Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike dhe E-Qeverisja.

Konvikti i nxënësve dhe studentëve është një nga institucionet që ofrojnë strehim për nxënës dhe studentë, kapaciteti i këtij konvikti momentalisht është 132 shtretër / me mundësi zgjerimi sipas nevojës.

Gjendja e objekteve shkollore dhe universitare ne Komunen e Gjilanit eshte e kenaqshme dhe viteve te fundit ka patur investime te konsiderueshme ne EE si dhe eshte investuar ne ngritjen e cilesise ne arsim permes organizimit te trajnimeve ne baza te rregullta per mesimdhenes.

Infrastruktura:

Infrastruktura në komunën e Gjilanit përfshin një gamë të gjerë të aspekteve të jetës së përditshme, të gjitha këto janë thelbësore për funksionimin e qytetit duke përfshirë:

- rrugët,
- sistemet e ujësjellës dhe kanalizimeve,
- energjia dhe ndriçimin publik,
- menaxhimi i mbeturinave,
- transportin ndër urban dhe urban
- telekomunikimi dhe
- mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike

Rrugët dhe trotualet : Komuna e Gjilanit ka një rrjet rrugor të zhvilluar, përfshirë rrugë kryesore që lidhin qytetin me qytete të tjera të Kosovës. Për të përmirësuar qasjen në rrugë dhe për të rritur sigurinë rrugore, vazhdimisht janë duke u bërë investime në ndërtimin dhe përmirësimin e rrugëve.

Komuna e Gjilanit po hyn në një fazë të re të zhvillimit, duke investuar në infrastrukturë moderne dhe duke krijuar kushte më të mira për jetesë, lëvizje dhe zhvillim ekonomik. Gjatë vitit 2025 janë realizuar një sërë projektsh strategjike, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën rrugore dhe shërbimet publike në qytet dhe në zonat rurale.

Projektet e realizuara gjatë vitit 2025 përfshijnë:

- Asfaltimin e rrugëve në **Livadhet e Arapit – Gjilan**, në gjatësi prej **7,356 m**;
- Asfaltimin e trotuarit në fshatin **Llashticë**, në gjatësi prej **2,261 m**;
- Ndërtimin e trotuarit në fshatin **Bresalc**, në gjatësi prej **1,768 m**;
- Instalimin e ndriçimit publik në **Bresalc**, në gjatësi prej **1,768 m**;
- Rikonstruktimin e rrugës "**Pajazit Ahmeti**", në gjatësi prej **280 m**;
- Rikonstruktimin e rrugëve "**Vëllezërit Frashëri**", "**Fatmir Ibishi**" dhe "**Nijazi Kadriu**", në gjatësi totale prej **1,340 m**.

Këto investime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të infrastrukturës komunale, rritjes së sigurisë në komunikacion, përmirësimit të qasjes në shërbime dhe krijimit të një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin ekonomik lokal. Përmes investimeve të vazhdueshme në infrastrukturë, Komuna e Gjilanit po forcon bazat për një zhvillim të qëndrueshëm, duke rritur cilësinë e jetës së qytetarëve dhe atraktivitetin e komunës për investime të reja.

Janë nënshkruam Memorandume të Bashkëfinancimit me Qeverinë e Kosovës në realizmi i këtyre projekteve :

- Ndërtimi i projektit të integruar të Bulevardit të qytetit i cili do ta bëjë transformimin me të madh urbanistik me 30 mijë m², 500 parkingje, duke e përfshirë edhe nënkalimin, 8,000 m² si dhe objektin e komunës së re.
- Investimet në qarkoren | rruga Qarkore Ekzistuese
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Ranatoc – Kokaj dhe
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Nekibe Kelmendi” Gjilan
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Fidanishte 2” Gjilan
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Hamdi Kurteshi” të FSK - Gjilan
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lidhëse në Livoq dhe Cernicë
- Ndërtimi i trotuarit në fshatin Bresalc.

Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit: Sistemi ujësjellës i Komunes së Gjilanit ka një kapacitet të përgjithshëm të prodhimit prej 303.6l/s, i cili furnizohet nga këto burime :

Nr	Emri i burimit	Kapaciteti	Lloji i burimit
		(l/s)	
1	Përlepnice	142.82	Liqen
2	Guri Hoxhës	39.59	Burim Nëntokësor
3	Baja	12.92	Burim Nëntokësor
4	Pusi 1 (Velekincë)	12.00	Pus
5	Pusi 2 (Velekincë)	12.00	Pus
6	Pusi 3 (Velekincë)	13.00	Pus
7	Pusi 4 (Velekincë)	14.00	Pus
8	Pusi 5 (Velekincë)	16.00	Pus
9	Pusi 6 (Velekincë)	16.00	Pus
10	Pusi 7 (Velekincë)	16.00	Pus
11	Malisheve e ulët	0.98	Pus
12	Malisheve e epërme	0.22	Pus
13	Dobërçan 1	1.00	Pus
14	Dobërçan 2	0.50	Pus
15	Dobërçan 3	0.40	Pus
16	Llovçë	0.08	Pus
17	Zhegër 1	3.50	Pus
18	Zhegër 2	2.58	Pus
19	Bilinicë	1	Pus
20	BH1 Fidanishte	1	Pus
21	BH2 Fidanishte	1	Pus

KRU “Hidromorava” ne Gjilan menaxhon me rrjetin e ujesjellesit dhe kanalizimeve ne Komunen e Gjilanit. Gjatesia e rrjetit te ujesjellesit primar eshte 344.24km’ ndersa ai sekondar 294 km dhe ky rrjet perveq qytetit eshte i shrire edhe ne fshatrat me te medha te komunes.

Numri i konsumatoreve te cilet marrin sherbime nga KRU “Hidromorava” per furnizim me uje eshte 28,677 ose 80% e popullesise ndersa ne rrjetin e kanalizimit jane te kycur rreth 77.5% e banoreve te Komunes se Gjilanit. .

Komuna aktualisht eshte duke realizuar sistemin e ujës-jellës në fshatin Uglar, Vërbice e Kmetocit, Vrapqiçi, Pogradjë, Bresalc si dhe pritët te filloj realizimi i sistemit te ujesjellesit edhe ne fshatin Cërrnice.

Vlen te theksohet se aktualisht jane ne proces te realizimit 2 projekte madhore si Impianti per trajtimin e ujerave te zeza (ITUZ) i cili do te ndertohet ne lokacionin e fshatit Uglar pikë e cila do të mundësojë grumbullimin e gjithë kolektorëve në një pikë përmes gravitetit.

Projekti është në fazën fillestare, shpronësimi i pronave në lokacionin ku do të ndërtohet ITUZ është përfunduar nga Komuna e Gjilanit dhe gjithashtu komuna e Gjilanit është në procedurë për përfundimin e shpronësimit – leje kalimit për trasenë ku do të kalojnë gypat e kanalizimit dhe ka dorëzuar zotimin për përfundimin e kësaj procedure në fillim të vitit 2025 në BERZH.

Liqenet artificiale

Komuna e Gjilanit ka dy liqenin e artificiale :

Liqeni Akumulues i Përlepnicës

Liqeni Akumulues i Livoçit

Liqeni Akumulues i Përlepnicës është ngritur në vitin 1966 shfrytëzohet edhe për pije edhe për ujitje të 350 hektarëve tokë të punuar. Liqeni akumulues i Përlepnicës është formuar në lumin me të njëjtin emër. Vëllimi i ujit të tij është 4.2 milionë m³. Ka një sipërfaqe prej 1.634 km², dhe prurje prej 16.32 m³ ujë në sekond.

Liqeni akumulues i Livoçit, gjendet në lumin e Livoçit dhe është në afërsi të Gjilanit, është qendër e rëndësishme rekreative e banorëve të qytetit dhe e popullsisë përreth. Prapa pendës së betontë, e cila është e lartë 21 metra, është formuar një akumulacion prej 1,6 milion m³ ujë.



Foto : Liqeni akumulues i Livoçit

Projekti tjetër me rendesi “FLOWS” , një investim nga Banka Botërore ka dy komponentë, njëri ka të bëjë me zgjerimin e kapaciteteve të ujit në komunën e Kamenicës, përmes studimit të fizibilitetit për ndërtimin e digave në lumin Desivojcë të Komunës së Kamenicës, ndërsa komponenta e dytë ka të bëjë me investimet në KRU Hidromorava në Gjilan sipas kërkesave të Menaxhmentit të KRU Hidromorava të bëra përmes disa takimeve të përbashkëta me përfaqësuesit e Bankës Botërore.

Ne kuader të projektit FLOWS planifkohet arrihen keto objektiva:

Ndërrimi i gypit transportues të ujësllës L=7,500m’, nga FPU- Përlepnice deri në hyrje të qytetit- puseta kryesore afër Qendrës Tregtare “Agmia” Gjilan.

Ndërtimi i gypit të ri nga rreth rrotullimi përballë fabrikës së IBG- Gjilan L=6,500m’, përgjatë rrugës qarkore deri të puseta kryesore e gypit të çelikut.

- Ripërtëritje e rrjetit ekzistues ujësllës L=3,000m’: nga puseta kryesore të Qendra Tregtare Agmia deri tek udhëkryqi i rrugës të kompleksi banesor “FITORJA”.

- Krijimi i DMA zonave për menaxhim të humbjeve të ujit: Gjilan, Viti dhe Kamenicë.
- Rritja e efikasitetit të energjisë - rivitalizimin e stacionit të pompave.
- Ndërtimi i rezervuarit të ri me vëllim $V = 3500\text{m}^3$ FPU Përlepnicë.

Energjia dhe ndriçimi publik: Situata e furnizimit me energji elektrike të qytetarëve në komunën e Gjilanit ndikohet nga situata e përgjithshme elektroenergjitike në vend dhe në vazhdimësi janë realizuar investime në këtë fushë që përfshijnë modernizimin e infrastrukturës së energjisë dhe instalimin e sistemeve të ndriçimit publik të efektshëm dhe të qëndrueshëm.

Komuna e Gjilanit furnizohet me energji elektrike nga 4 TS 35/10 kv : Gjilani I deri Gjilani IV dhe Lladova, 24 km lidhje kabllovike dhe 347 km lidhje ajrore me gjithsejtë 3476 shtylla elektrike dhe 271 trafo stacione 10/0.4 kv, me gjithsejtë 57 MVA fuqi instaluese 35/10(Kv) dhe 51.5 MVA fuqi instaluese Ts 110/35 (KV).

Investimi në trafo stacionin e ri “Gjilani V” perfundimisht ka zgjidh problemin e ngarkesave në trafo stacione sidomos gjatë sezonit dimëror. Vlen të nënvizohet se në qytet dhe pothuajse në të gjitha lagjet po ashtu edhe në fshatra tashmë kanë ndriçim publik funksional.

Menaxhimi i mbeturinave: Në Gjilan ekziston deponia regjionale e cila ndodhet në fshatin Velekicë (5km), ndërsa menaxhimin e mbeturinave e ben Ndërmarrja Publiko-Private “Ecohigjeina” ku si aktivitet primare ka grumbullimi, bartjen dhe deponimin e mbeturinave.

Gjatë vitit 2025 : Prodhimi ditor i mbeturinave: rreth 97.2 ton/dite, prodhimi vjetor i mbeturinave: rreth 25,666 ton/vit, Ndërmarrja Publiko-Private “Ecohigjeina” ofron shërbime në 32 vendbanime.

✓ numri i përgjithshëm i konsumtoreve është 21,175

✓ ekonomi familjare : 19,550

✓ numri bizneseve : 1,515

✓ numri i institucioneve 110

Ndërmarrja Publiko-Private "Ecohigjiena" Sh.A. në Gjilan është ndërmarrja e parë në Kosovë e themeluar dhe funksionalizuar sipas modelit të partneritetit publiko-privat (PPP) për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave.

Ky model ka kombinuar përgjegjësitë dhe mbikëqyrjen e sektorit publik me përvojën dhe efikasitetin e partnerit privat, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, rritjen e mbulueshmërisë dhe modernizimin e operacioneve.

Në kuadër të këtij sistemi, grumbullimi dhe transporti i mbeturinave realizohen nga Ndërmarrja Publiko-Private "Ecohigjiena" Sh.A. ndërsa trajtimi dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave kryhen në Deponinë Rajonale, e cila menaxhohet nga **Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK)**, një ndërmarrje publike në nivel qendror.

Ky organizim siguron ndarje të qartë të përgjegjësisë dhe një sistem të integruar të menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vitin 2025 Qeveria Kosovës ka nënshkruar marrëveshje me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) në vlerë mbi 12 milionë €, ku synohet përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave dhe një prej komunave perfituese është edhe Komuna e Gjilanit.

Transporti rrugor

Gjilani përshkohet nga tri arterie të rëndësishme komunikacioni: magjistralla Gjilan-Prishtinë që lidhet me rrugën e kombit me Shqipërinë, Gjilan-Shkup dhe Gjilan-Bujanovc që lidhet me koridorin Evropian VIII dhe X.

Një arterie tjetër e rëndësishme transporti është gjithashtu autostrada e re Gjilan-Prishtinë, e cila është në përfundim të sipër dhe e cila përbën një ndër zhvillimet më të rëndësishme në periudhën afatshkurtër për komunën e Gjilanit për sa i përket infrastrukturës.

Distanca rrugore Gjilan-Tiranë është 274 km, kurse me portin e Durrësit është 320 km dhe i Shëngjinit 290 km.

Gjithashtu ka lidhje të mira me linja të rregullta autobusi si Gjilan – Prishtinë, Gjilan - Ferizaj, Gjilan – Prizren, Gjilan - Kamenicë, Gjilan – Preshevë, Gjilan – Bujanovc, Gjilan – Likovë – Kumanovë: që lidh Gjilanin me disa qytete dhe fshatra në rajonin e Maqedonisë së Veriut si dhe linja për Shqipëri dhe Mal të Zi.



Grafiku 5. Harta e Kosovës dhe Regjioni i Gjilanit

Telekomunikimi : Telekom i Kosovës (TK) si operatori kryesor ofron një gamë të gjerë të shërbimeve telekomunikacioni, duke përfshirë telefoninë fikse dhe mobile, internetin e brendshëm dhe ndërkombëtar, si dhe shërbime të tjera të telekomunikacionit.

Përveç Telekomit të Kosovës, në Gjilan veprojnë edhe operatorë tjerë si IPKO, Kujtesa, ArtMotion që ofrojnë shërbime televizive dhe shërbime të tjera të internetit.

Mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike : Ndërmarrja Publike Lokale “ Tregu” Sh.A Gjilan është përgjegjëse për mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike e cila ka rreth 285 punëtorë të cilët janë të angazhuar edhe në mirëmbajtje të objekteve publike.



foto : parku “Baja” Gjilan

Komuna e Gjilanit është duke realizuar projekte për krijimin e hapësirave të reja “Xhepat e gjelbër” në disa lokacione si : parku Banja, parku Urban pjesa të posta e vogël, parku në fshatin Miresh, parku në fshatin Demiraj, e se shpejti do përfundojnë punimet në lagjen Iliria, në jetësim e sipër është edhe ai në lagjen Iliria, ndërsa punimet kanë filluar edhe në fshatin Shillovë.

Sipërfaqet e parqeve dhe hapësirave publike | Mirëmbajtja

sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në hektar : 12 ha

sipërfaqja e hapësirave publike komunale në hektar : 161.04 ha

sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht : 9,36 ha

numri i përgjithshme i hapësirave publike : 52

numri i hapësirave publike të pajisura me ndriçim publik eshë : 39

Komuna e Gjilanit me qëllim të parandalimit të vershimeve në vazhdimësi ka realizuar projekte për pastrimin e shtreterve të lumenjve dhe menaxhimin e mjedisit dhe infrastrukturës së ujit.



foto : pastrimit të shtratit të lumenjve - Gjilan

Pastrimi i shtreterve të lumenjve ndihmon në eliminimin e bllokimeve të mundshme që mund të krijohen brenda hapësirës së shtreterve të lumenjve nga grumbullimi i gjetheve, apo materialeve të tjera - mbeturinave.

Pastrimi rregullisht siguron që uji të kalojë pa pengesa, duke parandaluar përmytjet që mund të dëmtojnë pasuritë dhe infrastrukturën.

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Kujdesi shëndetësor ka një rëndësi kritike në mirëqenien e popullatës, në të cilën ndikojnë drejtpërdrejtë gjendja dhe niveli i shërbimit shëndetësor.

Në përgjithësi, sistemi shëndetësor dhe mirëqenia sociale në Gjilan kanë qenë në një proces të përmirësimit të vazhdueshëm. Komuna por edhe Qeveria ka bërë përpjekje për të rritur aksesin në kujdes shëndetësor dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

Numri i objekteve shëndetësore në Komunën e Gjilanit

- 1 - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)
- 12 - Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF)
- 9 – Ambulanta në Mjekësinë Familjare (AMF)

Në Komunën e Gjilanit, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) është institucioni qendror që ofron shërbime shëndetësore bazike për komunitetin lokal.

Qendrat e mjekësisë familjare janë shpesh pikat e parë të kontaktit për pacientët kur ata kanë nevojë për kujdes shëndetësor dhe shpesh përcaktojnë nëse pacientët duhet të drejtohen tek specialiste të tjerë për trajtim të mëtejshëm.

Të punësuar 244 punëtorë (mjek dhe infermier) po ashtu ekzistojnë edhe institucionet tjera shëndetësore si :

Qendra për Shëndetin Mendor

Shtëpia për Integrim në Bashkësi

Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës si dhe

Qendra për Punë Sociale

Qendrën e Kujdesit Ditor për Personat e Moshuar

Gjatë vitit 2025 Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanta në Mjekësinë Familjare (AMF) kanë kryer 293,512 shërbimeve dhe vizita – shërbime, moshë 0 – 65+, 1,004 – shërbime mamografi, 13,357 – shërbime stomatologjike, 8,179 – shërbime tjera (certifikata dhe dokumente të tjera)

Sistemi shëndetësor primar është duke u avancuar përmes modernizimit të shërbimeve mjekësore si: digjitalizimi i sistemit për konsultime online, krijimi i dosjeve elektronike të pacientëve, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut përmes promovimit dhe edukimit,

integrimin e shërbimeve: ku përfshihen specialistë të parandalimit të sëmundjeve, duke përfshirë fushën e vaksinimit, shëndetit mendor, stomatologë dhe shërbime sociale si dhe në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare po ngriten kapacitetet e personelit shëndetësor përmes shkëmbit të përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e shëndetit primar.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ofron shërbimin shëndetësor shtëpiak - Shërbimi shëndetësor paliativ e cila është e rëndësishme për ofrimin e ndihmës nga profesionistët shëndetësorë në kujdesin paliativ në shtëpi është thelbësore për sigurimin e një ambienti të rehatshëm dhe mbështetës për pacientët dhe familjet e tyre. Të gjitha këto shërbime ofrohen falas nga QKMF në Gjiilan dhe në bashkëpunim me Komunën e Gjiilanit.

Spitali Regjional i Gjiilanit ka 522 punëtorë prej tyre 109 mjeke specialiste, 319 infermier, 94 staf mbështetës: ekonomiste, bio-inxhinier, jurist dhe punëtorë tjerë ndihmës . Spitali Regjional i Gjiilanit ka kapacitet prej 450 shtretërve, 17 reparte : gjinekologjia, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektivë, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë - emergjenca, ORL, oftalmologjia, laborator, transfuzioni i gjakut, materniteti etj.



Spitali Regjional i Gjiilanit funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ofron shërbime shëndetësore për nivelin dytësor për popullatën e regjionit të Gjiilanit.

Komuna e Gjilani perkujdeset dhe i trajton sipas ligjeve ne fuqi familjet pa burime alternative të ardhurash (asistencë sociale). Sipas të dhënave zyrtare, për vitin 2025, numri i këtyre familjeve ishte 527 me 1,902 anëtarë ose përafërsisht 2.23 % e banoreve në Gjilan. Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas kategorive eshte si ne vijim:

- ✓ Numri i përfituesve të skemës të pensioneve për veteranët e luftës : 1,929
- ✓ Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e pensioneve për familjet dhe fëmijët e dëshmorëve dhe invalidët: 24 familje (56 fëmijë dhe 48 invalidë).
- ✓ Numri i përfituesve të pensionit bazike të moshës : 9,583
- ✓ Numri i përfituesve të pensionet kontribut paguese të moshës : 2,112
- ✓ Numri i përfituesve të pensionit për personave me aftësi të kufizuara : 1,343



Komuna e Gjilanit po te angazhohet që të rishikojë dhe optimizojë skemat e ndihmës sociale duke implementuar masa që mundësojnë rritjen e efikasitetit, po punohet që të krijohen mundësi për të ndihmuar individët dhe familjet të kalojnë nga varësia nga asistenca sociale në një situatë më të qëndrueshme dhe aktive në tregun e punës.

Ekonomia

Gjatë periudhes se sistemit socialist deri ne vitet 1999, industria ishte një nder sektoret kryesor i cili zinte vend te rendesishem të të gjithë prodhimit ne Gjilan dhe vend. Në komunë ishin përqendruar degë të rëndësishme të ekonomisë si fabrika e Bativerive “IBG”, fabrika e Tekstilit “Integj” fabrika e Duhanit “IDGJ”, Celikut “Celiku”, Radiatoreve “Jugoterm” si dhe industria e perpunimit te ushqimit “Agrokultura”...

Një pjesë e madhe e ndërmarrjeve dhe sektorëve të veçantë të mësipërm pësuan rënie apo u mbyllën si pasojë e privatizimit të ndermarrjeve shoqerore ne Kosove.

Orientimi i ri drejt ekonomisë së tregut krijoi mundësinë e pjesëmarrjes së gjithmonë e më shumë aktorëve dhe individëve privatë në ekonominë në formim të Gjilanit duke kontribuar në krijimin e bizneseve te reja dhe zhvillimin e sektorit privat. Rritja graduale e numrit të bizneseve të reja të çelura çdo vit ndihmoi në rimëkëmbjen e ekonomisë edhe pse ende nuk eshte ne nivelin e kenaqshem.

Zhvillimi ekonomik i periudhës së tranzicionit është karakterizuar gjithashtu nga mungesa e një orientimi të mirëfilltë për sa i përket shtrirjes gjeografike të investimeve të sektorit privat.

Në mjaft raste bizneset e reja janë hapur duke mos marrë parasysh përqendrimin e bizneseve ekzistuese, tregun dhe kriteret të tjera përcaktuese për vendosjen e bizneseve në një lokacion të caktuar.

Hapja e bizneseve të reja i ka shërbyer më mirë plotësimit të nevojave të banoreve megjithatë, në mjaft raste, nëpër qytet vërehet një përqendrim i dendur i aktiviteteve të të njëjtit lloj në hapësira të vogla.

Gjatë periudhës së tranzicionit ekonomia në Gjilan është rritur me ritme te shpejta, por megjithatë pesha kryesore e saj mbetet e përqendruar në bizneset e vogla.

Sipas të dhënave zyrtare aktualisht ekzistojnë mbi 11,013¹ biznese të regjistruara derisa 7,068 jane biznese aktive ku dominojne bizneset individuale me 53.49% pasuar nga NVM me 44.55% siq jane prezantuar ne tabelë .

¹ Burimi ATK, <https://www.atk-ks.org/>

Lloji i biznesit	Nr. i bizneseve	në %
Biznese individuale	3,781	53.49
Kompani te huaja	16	0.23
Kooperativa & K. Bujqesore	2	0.03
Ortakeri e perbashket & pergjithshme	44	0.62
SHPK	3,149	44.55
Shoqeri aksionare	5	0.21
Tjera	61	0.86
Gjithsej	7,068	100%

Sektori privat i cili mbizotërohet nga bizneset e vogla, ka luajtur nje rol të rendesishem ne zhvillimin ekonomik te Komunes se Gjilanit. Vetëm 11.98 % e ndërmarrjeve janë të angazhuara në krijimin e vlerës së re – në prodhim ndërsa 74% e bizneseve janë të angazhuara në aktivitete tregtare e shërbyese.

Sektori	Nr. bizneseve	në %
Industri perpunuese	847	11.98
Tregti	2,412	34.13
Ndertimtari	601	8.50
Bujqesi	360	5.09
Akomodim dhe gastronomi	702	9.93
Arsim	72	1.02
Sherbim dhe aktivtete tjera sherbyese	2,074	29.34
Gjithsej	7,068	100%

Sipas raportit te Drejtorise per Zhvillim Ekonomik respektivisht Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QKRB) në Gjilan nga viti 2010 deri në fund te vitit 2025 jane regjistruar:

Biznese Prodhuese : 1,119

Biznese Tregtare : 2,291

Biznese Shërbyese : 4,049

Biznese Ndërtimore : 592

Biznese Pronare Femra : 1,626

Biznese Pronar Meshkuj : 6,425

Gjithsej biznese të regjistruara : 8,051

Punëtorë të deklaruar : 13,385

Skema 1 : Biznese të regjistruara 2010 - 2025

Emërtimet	Të regjistruara 2010 - 2025															
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Prodhuese	24	47	96	82	78	59	82	80	60	78	93	73	93	72	88	14
Tregtare	223	202	207	173	160	139	139	114	125	125	115	151	122	124	150	22
Shërbyese	90	223	276	272	263	276	313	230	254	269	241	270	313	385	331	43
Ndërtimore	9	41	32	34	35	45	41	49	46	41	53	45	41	32	43	5
Gjithsej	346	513	611	561	536	519	575	473	485	513	502	539	569	613	612	84
Emërtimet	Të regjistruara 2010 - 2025															
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Pronar femra	58	68	95	122	93	99	104	77	106	101	91	129	122	155	134	72
Pronar meshkuj	288	445	516	439	443	420	471	396	379	412	411	410	447	458	478	12
Gjithsej	346	513	611	561	536	519	575	473	485	513	502	539	569	613	612	84
Punëtorë	463	817	1209	956	880	837	962	824	743	910	798	850	887	1073	1060	116

Po ashtu sipas raportit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik respektivisht Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QKRB) në Gjiilan nga viti 2010 deri në fund të vitit 2025 janë ç’regjistruar:

Biznese Prodhuese : 216

Biznese Tregtare : 651

Biznese Shërbyese : 1,080

Biznese Ndërtimore : 129

Biznese Pronare Femra : 604

Biznese Pronar Meshkuj : 1,498

Gjithsej biznese të regjistruara : 2,076

Punëtorë të deklaruar : 3,191

Skema 2 : Të ç’regjistruara 2010 - 2025

Emërtimet	Të ç’regjistruara 2010 - 2025															
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Prodhuese	0	6	4	9	8	8	10	9	3	10	8	9	9	14	10	99
Tregtare	13	74	26	52	31	48	31	26	21	19	32	29	32	28	25	164
Shërbyese	8	25	39	48	45	51	40	40	44	44	36	52	70	78	65	395
Ndërtimore	0	5	4	5	5	8	10	3	2	4	5	10	3	4	3	58
Gjithsej	21	110	73	114	89	115	91	78	70	77	81	100	114	124	103	716
Emërtimet	Të ç’regjistruara 2010 - 2025															
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Pronar femra	7	6	8	18	25	19	11	10	20	19	14	19	91	94	85	158
Pronar meshkuj	14	104	65	96	64	96	80	68	50	58	67	81	23	30	18	584
Gjithsej	21	110	73	114	89	115	91	78	70	77	81	100	114	124	103	716
Punëtorë	39	131	107	138	123	163	176	113	105	93	115	150	148	166	156	1268

Sipas të dhënave të Qendrës për Regjistrim të Bizneseve (QKRB) në Gjiilan për periudhën 2010–2025, zhvillimi ekonomik lokal paraqet një trend përgjithësisht pozitiv dhe në rritje.

Gjatë kësaj periudhe dominon sektori i shërbimeve, i ndjekur nga tregtia, prodhimi dhe ndërtimtaria. Një element veçanërisht i rëndësishëm është rritja e pjesëmarrjes së grave në ekonomi, ku bizneset e udhëhequra nga pronare femra përbëjnë një segment të dukshëm dhe në rritje të sipërmarrjes lokale, duke reflektuar fuqizimin ekonomik të grave në komunë.

Në përgjithësi, këto të dhëna tregojnë një rritje të qëndrueshme të aktivitetit ekonomik në komunën e Gjiilanit, me dominim të sektorit të shërbimeve dhe zgjerim të vazhdueshëm të sipërmarrjes lokale.

Vlen të nenvizohet se aktualisht ekonomia lokale e Gjiilanit përfshinë një gamë të gjerë aktiviteteve ekonomike dhe sektorët kryesorë përfshijnë:

1. **Industria e ushqimit** : Gjiilani ka një sektor të zhvilluar të prodhimit të ushqimeve, duke përfshirë prodhimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore.
2. **Industria e prodhimit të radiatorëve** : njohur si Jugoterm, fabrika e radiatorëve “Enrad” ka afro 40 vite përvojë dhe është një nga prodhuesit kryesorë të radiatorëve panel dhe gypor në Kosovë dhe në rajon.
3. **Tregtia dhe shërbimet**: Gjiilani ka një aktivitet të zhvilluar tregtar dhe sektor shërbimesh, duke përfshirë biznese të ndryshme si restorante, hotele, dhe shërbime të tjera të konsumit.
4. **Industria e ndërtimit**: Ndërtimi është një sektor që ka rritur rëndësinë në vitet e fundit, me zhvillime të reja të objekteve të banimit dhe infrastrukturës.

Sidoqoftë, komuniteti i biznesit ende përballlet me sfida, ndër pengesat kryesore për rritjen e afarizmit të bizneseve dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, mbeten mungesa e kapitalit qarkullues, sigurimi i lëndës së parë, mungesa e investimeve, qasja në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, etj.

Komuna e Gjiilanit luan një rol kyç rregullator lidhur me nxitjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, përmes përcaktimit të nivelit të taksave komunale, ofrimit të shërbimeve administrative efikase dhe cilësore.

Sigurimi i një infrastrukture bazike të përshtatshme mbetet një nga faktorët kyç për zhvillimin e sektorit privat. Infrastruktura biznesore që aktualisht ka Komuna e Gjiilanit është Inkubatori i Biznesit, ndërkohë që është realizuar studimi i fizibilitetit për krijimin e një Zone të re Ekonomike me një sipërfaqe prej 146.5

hektarësh, dhe Studimi i Fizibilitetit për Inkubatorin e Biznesit të cila do të ofrojnë kushte dhe hapësira për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit privat, duke e bërë Gjilanin një qytet atraktiv për investime në të ardhmen.

Për të adresuar nevojat e bizneseve për zgjerim Komuna e Gjilanit në kuadër të kompetencave të saj ofron:

- ✓ *Dhënia e tokës në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vite*
- ✓ *Krijimin e Zonës Ekonomike (Studimi i fizibilitetit i perfunduar)*
- ✓ *Subvencionimi i bizneseve të reja START-UP dhe bizneseve ekzistuese të grave*
- ✓ *Lehtësira në të bërit biznes duke i liruar nga pagesa e takses komunale për ushtrim të veprimtarisë afariste në territorin e Komunes së Gjilanit*
- ✓ *Mundesinë për investime në projekte zhvillimore përmes PPP*
- ✓ *Funksionalizimin e IB në IB –TIK*

Bazuar në ligjin në fuqi, Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komuna e Gjilanit mund të jep me qira shfrytëzimin e tokës për periudhë afatshkurtër (1-15 vjet) ose afatgjatë (15-99 vjet).

Aktualisht Komuna e Gjilanit, përmes Drejtorisë së Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës, ka identifikuar 51 parcela të paluajtshme, në 14 zona kadastrale të disponueshme për investitorë vendorë dhe ndërkombëtarë, me fokus në zhvillimin ekonomik dhe interesin publik.

Struktura e parcelave sipas destinimit:

- ✓ 22 parcela për bujqësi
- ✓ 3 parcela për afarizëm dhe bujqësi
- ✓ 2 parcela për turizëm, rekreacion dhe hoteleri
- ✓ 3 parcela për blegtori dhe shpezëtari
- ✓ 2 parcela për pemtari dhe aktivitete të ngjashme
- ✓ 1 parcelë për afarizëm, sport, rekreacion dhe energji solare
- ✓ 2 parcela për pemtari
- ✓ 1 parcelë për industri dhe bujqësi
- ✓ 1 parcelë për bujqësi, turizëm dhe rekreacion
- ✓ 1 parcelë për energji të ripërtëritshme (erë dhe diell)
- ✓ 2 parcela për energji të ripërtëritshme dhe zhvillim afarist
- ✓ 4 parcela për veprimtari afariste
- ✓ 6 parcela për turizëm malor/rural dhe energji të ripërtëritshme

Lista e pronave të paluajtshme komunale për dhënie në shfrytëzim është e publikuar në webfaqe të komunës së Gjilanit² ndërsa pjesë integrale e këtij dokumenti është edhe katalogu i këtyre pronave të paluajtshme me të gjitha të dhënat si madhësia e sipërfaqes, vendndodhja, kulturat, destinimin e përafërt të gjitha të paraqitura me ortfoto të nxjerra nga gjeoportali shtetëror sipas zonave kadastrale dhe sipas Sistemit të Informatave Kadastrale të Tokave të Kosovës (SIKTK)

Destinimi i këtyre pronave është dhënë në baze të vendndodhjes dhe kultures së tyre por mund të ndryshohet sipas interesimit të shfrytëzuesve potencial me ndonjë projekt konkret i cili duhet të jetë i bazuar edhe në planin zhvillimor komunal.

Komuna e Gjilanit ka në mjedis të shkëlqyer për bizneset start-up dhe aktualisht është planifikuar shendërrimi i IB në Inkubator të TIK me fokus ndërmarrësit e rinj me ide biznesi inovative në fushën e TIK të cilëve do të ju krijohen kushte për zhvillimin e afarizmit të tyre.

Gjithashtu, Komuna në bashkëpunim me akterë relevant vazhdimisht po zhvillon programe për mbështetje financiare (subvencione), trajnime për start-up për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e ndërmarrësisë, si dhe për të nxitur dhe inkurajuar krijimin e start-up dhe inovacioneve të reja përfshirë fuqizimin e grave ndërmarrëse në Gjilan.

Komuna e Gjilanit ka 30 biznese të huaja të cilat operojnë në Gjilan si dhe dhjetra biznese nga diaspora të cilët kanë investuar në sektore të ndryshme të ekonomisë.

Sidoqoftë, diaspora paraqet një potencial real për të ndikuar në rritjen ekonomike lokale. Investimet përmes PPP (Partneriteti Publiko Privat) në projekte në fushën e energjisë, turizmit shëndetësor, infrastrukture biznesore etj inkurajohen nga Komuna e Gjilanit me qëllim të rritjes së konkurrencës së produkteve dhe shërbimeve si dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Përveç kësaj, Kosova ka krijuar një kornizë ligjore që u garanton investitorëve të huaj të drejtën e përfshirjes dhe trajtimit në pothuajse çdo sektor të ekonomisë, duke ofruar stimuj tërheqës për kompanitë e huaja në vend.

Mjedisi afarist në Kosovë po bëhet një nga më konkurrentët në rajon duke ofruar mundësitë më të mëdha për investime, prandaj një arsye e fortë për të tërhequr investitorët e huaj si vend primar për investimet e tyre janë:

² <https://kk.rks-gov.net/gjilan/gjilani/pronatkomunale>

- Kosto më e ulët operative në Evropë
- Euro është monedha zyrtare
- Çasje e lirë në tregjet e BE-së, SHBA-së dhe vendeve të CEFTA-s
- Popullsia më e re në Evropë
- Legjislacioni në përputhje me standardet e BE-së
- Sistemi bankar i qëndrueshëm
- Taksa të ulëta
- Lokacioni strategjik me zhvillim të vazhdueshëm të infrastrukturës
- Situata politike stabile
- Fuqia punëtore me aftësi të shumta
- Gjuha angleze dhe gjermane përdoren nga shumica

Tregu i Punës – Sipas të dhënave të Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, përkatësisht Zyra e Punësimit në Gjilan, deri në prill 2026 në komunën e Gjilanit kemi këto të dhëna :

- 2823 jane puneckerkues aktiv;
- 3346 jane puneckerkues pasiv.
- 6,169 gjithsej punëkërkues

Këto të dhëna reflektojnë nivelin e lartë të papunësisë dhe sfidat e vazhdueshme të tregut lokal të punës. Tregu i punës në komunën e Gjilanit, ngjashëm me shumicën e komunave në Kosovë, vazhdon të karakterizohet nga një nivel i pamjaftueshëm i punësimit dhe nga mospërputhja ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.

Pavarësisht nivelit të kualifikimeve dhe përgatitjes profesionale të qytetarëve, mundësitë për punësim mbeten të kufizuara si rezultat i numrit të pamjaftueshëm të vendeve të reja të punës dhe ritmit të ngadalshëm të zhvillimit ekonomik lokal.

Struktura e punësimit dominohet nga sektori privat, i cili përbëhet kryesisht nga biznese mikro me kapacitete të vogla punësimi, ku shumica e tyre angazhojnë nga 1 deri në 9 punëtorë.


Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), edhe pse përbëjnë bazën e aktivitetit ekonomik lokal, ende nuk kanë arritur të japin kontribut të mjaftueshëm në zgjerimin e punësimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës përmes rritjes dhe zhvillimit të aktiviteteve të tyre.

Situata aktuale në tregun e punës ndikon drejtpërdrejt edhe në nivelin e mirëqenies ekonomike dhe sociale të qytetarëve.

Të hyrat familjare vazhdojnë të varen kryesisht nga punësimi në sektorin publik dhe privat, ndërsa remitencat nga diaspora mbeten një burim shumë i rëndësishëm financiar për një numër të konsiderueshëm të familjeve në komunën e Gjilanit.

Emigrimi i vazhdueshëm dhe prania e anëtarëve të familjeve në shtetet perëndimore vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në mbështetjen e konsumit familjar dhe stabilitetit ekonomik lokal.

Në këtë kontekst, zhvillimi ekonomik lokal kërkon politika më aktive për stimulimin e investimeve, mbështetjen e NVM-ve, zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me nevojat e tregut dhe krijimin e kushteve më të favorshme për hapjen e vendeve të reja të punës, me fokus të veçantë tek të rinjtë dhe grat



Gjilani konsiderohet si një qender rajonale dhe administrative për shkak të prezences së një varg institucionesh të cilat ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh publike dhe private që shërbejnë rajonin përreth, duke përfshirë:

- Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
- Qendra për Aftësim Profesional
- Administrata Tatimore e Kosovës
- Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës
- Agjencioni për Zhvillim Rajonal (AZHR)

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e pagës minimale, nga **1 korriku 2026** paga minimale është **500 € bruto në muaj** për të gjithë të punësuarit me orar të plotë të punës ne sektorin privat.

Kjo masë synon përmirësimin e standardit jetësor të punëtorëve, rritjen e mirëqenies sociale dhe përafrimin gradual të nivelit të pagave me zhvillimet ekonomike dhe koston e jetesës në vend.

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), paga mesatare bruto në Kosovë është **713 €** në muaj. Kjo pagë përfaqëson nivelin mesatar të të ardhurave nga puna në nivel vendi dhe shërben si një tregues i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik, nivelit të mirëqenies së qytetarëve dhe lëvizjeve në tregun e punës.

Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet pagave në sektorin publik dhe atij privat, si dhe ndërmjet degëve të ndryshme të ekonomisë.

Nje institucion tjetër i rëndësishëm në aspektin e përgatitjes së fuqisë punëtore është edhe Qendra për Aftësim Profesional (QAP Gjilan) i cili ofron trajnime profesionale me kohëzgjatje prej 3-6 muaj në keto drejtime:

- Zdrukthtari, Saldues,
- Dizajn Grafik & Multimedia,
- Kontabilitet,
- Rrobaqepësi dhe
- Kuzhinieri.

Qendra për Aftësim Profesional (QAP) Gjilan është një nga mekanizmat më të rëndësishëm për komunitetin e biznesit, pasi kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e kuadrove të kualifikuara sipas nevojave reale të tregut lokal të punës. Trajnimet janë plotësisht **falas**, duke e bërë këtë qendër një mundësi të qasshme për të rinjtë dhe qytetarët që synojnë aftësim profesional dhe punësim më të shpejtë.

Qendra për Aftësim Profesional (QAP) në Gjilan funksionon në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), e cila vepron nën përgjegjësinë e nivelit qendror. Trajnimet zhvillohen sipas programeve të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural:

Në vështrim të traditës dhe përvojës së qytetareve si dhe kushteve natyrore të favorshme, agrobiznesi shfaqet si një nga sektorët më me potencialë të zhvillimit për komunën e Gjilanit. Toka e pasur, relievi fushor kodrinor, klima dhe pozicioni i favorshëm gjeografik bashkohen me kapitalin njerezor për të investuar në këtë sektor. Gjilani ka një traditë bujqësore të theksuar me afër 50 % e banorëve të komunës së Gjilanit jetojnë në vendbanimet rurale ku bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave për shumicën e banorëve të këtyre zonave.

Komuna e Gjilanit nga sipërfaqja e përgjithshme e saj e cila është 39,071 hektarë, 99,75% është mbulesë tokësore, ndërsa 0,25%, ose 96,5 hektarë është e mbuluar me ujë, 54,1% e tokës përbëhet nga pyje, ndërsa 45,99% është tokë bujqësore. Shumica e pyjeve (6,89%) përbëhen nga pemë halore, 93.11% nga pemë gjetherënëse. Sipërfaqja e tokës bujqësore në shfrytëzim është 17 969 ha, ndërsa kopsht edhe sera kemi 46 ha.

Numri i ekonomive bujqësore është 4,165 ferma, me grurë janë 2,970 ha, misër 1,043 ha, perime 121 ha. Me pemë frutore janë 294 ha, prej tyre mollë 126.80 ha, kumbull 74 ha, vishnje 46 ha, dardhë 13 ha, dredhëz 10 ha, dhe mjedër 13 ha.



Sa i përket blegtorisë, aktualisht janë të evidentuara 2,700 krerë gjedhe, në 300 ekonomi bujqësore, 5,200 dele në 80 ekonomi bujqësore si dhe 1,500 krerë dhi në 60 ekonomi bujqësore. Gjithashtu në komunën e Gjilanit ka pula vojse rreth 26,700 copë në tri ferma

të mëdha dhe rreth 10.000 pula në ekonomitë familjare, bletë (koshere) 9,000 në 230 ekonomi bujqësore, derra rreth 900 krerë. Po ashtu janë edhe 2 qumështore, 5 thetore si dhe 4 ambulanca veterinare.

Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas Ligjit Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës dhe që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës(IKNP), shumë zona, monumente dhe vlera të tjera natyrore janë mbrojtur ligjërisht, duke përfshirë asetet e trashëgimisë natyrore. Zona e mbrojtur në komunën e Gjilanit mbulon 3.18 hektarë

Komuna e Gjilanit çdo vit është duke rritur buxhetin e saj dedikuar për subvencione në bujqësi. Gjithashtu një kontribut të konsiderueshëm janë duke dhënë edhe organizatat e ndryshme jo qeveritare dhe qeveritare nga vendet e ndryshme. Po ashtu fermerët çdo vit përfitojnë nga grantet dhe subvencionet që ndanë Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Janë hapur dhe riparuar shumë rrugë bujqësore. Sot të gjithë fermerët kanë qasje në pronat e tyre me çfarëdo lloj mekanizmi (makine) bujqësor/e.

Bujqësia dhe zhvillimi rural si objektiv tjetër është avancimi i teknologjisë përpunuese përmes mekanizimit bujqësor duke i subvencionuar fermerët për çdo vit me mekanizëm bujqësor. Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm modern bujqësor, ndikon direkt në cilësinë e produkteve të cilat përdorën në industrinë agropërpunuese, e që i ndihmon fermerët t'i rrisin kapacitetet e tyre.

Bujqësia dhe zhvillimi rural : si objektiv tjetër është organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve të fermerëve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale, mbështetja me qëllim të avancimit të teknologjive të prodhimit, pastaj modernizimi i mekanizimit (makinave) bujqësor/e etj.

Zhvillimi i këtyre aspekteve do të ndikojë në inkurajimin e fermerëve për të rritur kapacitetet e tyre prodhuese, për të shtuar rendimentin dhe cilësinë e prodhimit, për të investuar në marketingun e produkteve bujqësore dhe të gjitha këto do të ndikojnë në intensifikim e zhvillimit të tyre.

Spektori bujqësor është gjithashtu i rëndësishëm në ekonominë e Gjilanit, me prodhim të kulturave të ndryshme bujqësore. Bujqësia dhe zhvillimi rural janë sektorë thelbësorë për ekonominë lokale, sigurinë ushqimore dhe tërheqjen e investimeve në zonat rurale.

Spektori bujqësor është gjithashtu i rëndësishëm në ekonominë e Gjilanit, me prodhim të kulturave të ndryshme bujqësore dhe bimorë.

Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

Vlerat dhe pasuritë natyrore si dhe ato historike e kulturore në Komunen e Gjilanit përfaqësojnë potenciale të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të turizmit. Ky sektor me potencial të madh është ende i pashfrytëzuar.

Për nga aspekti turistik komuna e Gjilanit mund të ndahet në këto lokalitete turistike: Malet e Zhegocit; Malet e Karadakut (ose Malet e Zeza) , Malet e Sllubicës, Lugu i Haxhajve të Zhegrës, Lugu i Bukovikut , Lugu i Burincës , Gryka e Llapushnicës, Shpella e Bresalcit, Shpella e Resulës, Lumi Morava e Binçës, Lumi Mirusha , Liqeni i Livoçit, Uji Mineral i Nasalës, Burimi i ujit në fshatin Pidiq , si dhe Banjat minerale: Banja e Uglarit , Banja e Mireshtit, dhe Banja e Dunavit.

Gjilani ka dy Muze ne Qytet dhe ate Muzeun Rajonal dhe Muzeun Etnologjik. Muzeu Etnologjik i Gjilanit është një vend ku mund të studiohet historiku dhe kultura e Gjilanit dhe rajonit përreth. Trashëgimia kulturore në shërbim të zhvillimit të turizmit siç është Muzeu i Qytetit i cili ndryshe njihet si “Objekti i Kajmekamllakut” gjendet në qendër të qytetit. Shkolla e Muzikës, përballë Atik Xhamisë, ky objekt quhej Saraji i Mustafë Pashës;



Diversiteti fetar e kulturor | Komuna e Gjilanit karakterizohet me një diversitet i madh fetar dhe kulturor. Popullsia me shumicën u përkasin besimit mysliman, ka një pjesë të popullsisë që janë të krishterë dhe të tjerë. Në përgjithësi, Gjilani është një shembull i mirë i harmonisë së komuniteteve fetare dhe kulturore në një mjedis urban.

Komuna e Gjilanit ka 41 xhami dhe 8 kisha ortodokse dhe 1 kish katolike në fshatin Dunav (burimi: përfaqësues të bashkësive fetare). Gjithsej 64 objekte të trashëgimisë kulturore (27 arkeologjike dhe 37 arkitekture) janë përfshirë në listën e vendeve në mbrojtje të përhershme dhe përkohshme të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit Vlen të permenden Atik Xhamia, xhamia e Cernicës, xhamia e Dobërçanit, kisha katolike „Kisha e Shën Anës” në fshatin Dunavë, tyrbet në qytet, kisha e Shën Nikollës, Sahat Kulla.

Komuna e Gjilanit posedon Kalane e Pogragjës e gjendet në kilometrin e 10 nga qyteti i Gjilanit, në fshatin Pogragjë. Krahës kalasë është mjaft atraktive edhe Gryka e Llapushnicës, pastaj fortifikata parahistorike në Cërnice si dhe monumentet e trashëgimisë kulturore si Kalaja e Mireshtit, Kalaja e Pidiqit, Kalaja e Përlepnices, etj.

Komuna e Gjilanit ka edhe atraksione natyrore si Penda e Livoçit, lokaliteti Stublinë, lokaliteti Zhegoc me rrethinë, lokaliteti Stanishor me rrethinë, liqeni i Përlepnices, dhe burimet termale në Uglar dhe Dobërçan.



Harta: Disa nga objektet e trashëgimisë kulturore


Në komunën e Gjilanit janë 244 ndërmarrje dhe punëtori hoteliere të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime akomodimi, ushqim, pije alkoolike dhe joalkoolike, ahengjeve familjare, salla për seminareve, trajnime dhe shërbimeve të tjera.

Sektori i gastronomisë dhe hotelerisë në Komunën e Gjilanit përfaqëson një nga degët më dinamike të ekonomisë lokale. Në këtë sektor operojnë një numër i konsiderueshëm restorantesh, hotelesh, resorteve, kafeneve dhe lokaleve të tjera shërbyese, të cilat kontribuojnë në punësim, zhvillimin e turizmit lokal dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe vizitorët.

Ndër bizneset më të njohura dhe me kapacitetet më të mëdha në këtë sektor veçohen Vali Ranch Resort, Resort Planet, Hotel Astoria Luxury & SPA, Restaurant Bujana, Restaurant Garden, Restaurant Lata, Kimi Coffee and Cake House, Restaurant Cuco, Bon Ami, Taverna Vjeter, Taverna 501 dhe Restaurant Egnatia, të cilat ofrojnë shërbime hoteliere, gastronomike dhe organizim të ngjarjeve të ndryshme.

Zip Line Green Valley (Pogragjë, Gjilan) është një nga projektet dhe atraksionet kryesore të turizmit të aventurës në Rajonin Ekonomik Lindor të Kosovës. Ndodhet në një zonë me peizazh të pasur natyror (Gryka e Pogragjës) dhe afër Kalasë historike të Pogragjës, duke ndërlidhur turizmin natyror me atë kulturor.

Tërheq vizitorë vendas dhe të huaj, gjë që stimulon ekonominë e zonës përmes rritjes së kërkesës për shërbime gastronomike, hotelieri dhe produkte lokale.



Përfaqëson një model të suksesshëm të investimeve private në turizmin aktiv, duke krijuar vende të reja pune për të rinjtë dhe duke diversifikuar ofertën turistike të komunës së Gjilanit.

Promovimi i kësaj pike ndihmon në pozicionimin e Gjilanit si një destinacion i rëndësishëm i "eko-turizmit" dhe turizmit të aventurës në Kosovë.

Jeta kulturore në qytetin e Gjilanit është përqendruar në aktivitetin e disa institucioneve kulturore kyçe si “Teatri i qytetit”. Teatri ka një kapacitet prej 350 vendesh dhe përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme të zhvillimit artistik dhe kulturor të qytetit. Teatri ka trupën profesioniste e cila ka një angazhim të përhershëm artistik duke vënë në skenë vepra të ndryshme dhe aktivitete të rëndësishme.

Një prej ngjarjeve më të rëndësishme kulturore “Flaka e Janarit” është një festival kulturor multidimensional, i cili fillon më 11 janar në Gjilan me ndezjen simbolike të flakadantit, për të vazhduar deri më 31 janar me aktivitete të ndryshme kulturore.

Biblioteka e Qytetit “Fan S Noli” Gjilan është një nga bibliotekat më të mira të vendit dhe një institucion kulturor mjaft i rëndësishëm në Gjilan. Në fondin e saj ka mbi 100,000 libra, duke tërhequr në vitin 2025 rreth 5,200 lexues të regjistruar. Në bibliotekë zhvillohen aktivitete të ndryshme si promovime të librave të rinj, diskutime krijuese dhe ekspozita të librit.



Galeria e Arteve-Gjilan: Tani operon me program vjetor të saj, ku minimum gjatë vitit ndodhin 12 e më shumë ekspozita të artit pamor. Po ashtu në ndërtim është edhe “Kult Qendra” pra, një qendër e re e kulturës në lagjen Dardania, ku ngërthen në vetë sallën e teatrit e cila do të shfrytëzohet edhe për kinema, Galerinë e Arteve dhe hapësira të tjera rekreative brenda saj.

Monumentet historike : Varrezat e Dëshmorëve është një vend i rëndësishëm historik dhe memorial i cili i kushtohet dëshmorëve të qytetit të Gjilanit që sakrifikuan jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

4.2 Krahasimi me vendet/komunat të tjera

Komuna e Gjilanit, si njëra nga komunat më të mëdha të Republikës së Kosovës dhe qendër kryesore e rajonit të Anamoravës, krahasohet kryesisht me komunat fqinje dhe qendrat me të cilat ka lidhje ekonomike, sociale dhe infrastrukturore. Në nivel vendor, krahasimi bëhet me komunat e **Vitisë, Kamenicës, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit dhe Ranillugut**, të cilat përbëjnë hapësirën funksionale të Anamoravës.

Në aspektin rajonal, Gjilani krahasohet edhe me **Komunën e Ferizajt**, për shkak të rolit të ngjashëm si qendër urbane dhe ekonomike në pjesën juglindore të Kosovës, si dhe për lidhjet në fushën e tregtisë, arsimit, shërbimeve dhe zhvillimit ekonomik. Rajoni i Gjilanit dhe ai i Ferizajt shpesh trajtohen së bashku në planifikime ndërkomunale për shkak të ndërveprimit funksional ndërmjet tyre.

Në aspektin ndërkufitar, Gjilani ka lidhje të rëndësishme me komunat e **Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në Serbi**, si dhe me **Kumanovën në Maqedoninë e Veriut**, duke krijuar mundësi për bashkëpunim ekonomik, tregtar dhe kulturor. Pozita gjeografike e Gjilanit, afërsia me këto qendra dhe lidhjet rrugore e bëjnë atë një pikë të rëndësishme për zhvillimin rajonal.

Komuna e Gjilanit, në raport me Komunën e Prishtinës si kryeqytet i Republikës së Kosovës, paraqet një profil të ndryshëm zhvillimor dhe funksional.

Prishtina ka rol kombëtar si kryeqendër e Kosovës, ndërsa Gjilani ka rol rajonal si qendër e Anamoravës. Zhvillimi i Gjilanit po orientohet drejt fuqizimit të ekonomisë lokale, shfrytëzimit të pozitës gjeografike, zhvillimit të industrisë, bujqësisë, turizmit dhe bashkëpunimit ndërkufitar, duke plotësuar dhe krijuar lidhje funksionale me qendrën kryesore të vendit.

Lumi Morava e Binçës përbën një element të rëndësishëm natyror dhe ekonomik që lidh pjesën më të madhe të këtij rajoni, duke përkrahur territorin e komunave të Anamoravës dhe duke krijuar një hapësirë të përbashkët zhvillimore.

Përmes kësaj lidhjeje natyrore, komunat e Gjilanit, Vitisë, Kamenicës, Klllokotit, Parteshit dhe Ranillugut kanë potenciale të përbashkëta në bujqësi, menaxhim të resurseve ujore, turizëm rural dhe zhvillim ekonomik.

Ndërsa Novobërda, megjithëse nuk shtrihet drejtpërdrejt në të njëjtën vijë të lumit, plotëson këtë mozaik rajonal përmes trashëgimisë kulturore, resurseve natyrore dhe potencialit turistik

4.3 SWOT analiza

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal e Komunes së Gjilanit parashikon të ndërtoj të ardhmen mbi faktorët pozitivë, duke ndërtuar në të njëjtën kohë mekanizma për shmangien e ndikimeve negative në Gjilan.

Këta faktorë pozitivë dhe negativë që ndikojnë në komune, të cilët vijnë nga mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm u identifikuan dhe analizuan për secilën nga fushat e mësipërme përgjatë procesit të konsultimit dhe bashkëpunimit të ngushtë me Grupin Punues (GP) dhe palët e interesuara të Komunes së Gjilanit.

Identifikimi i faktorëve ndikues dhe tendencave në zhvillim janë çelësi për formulimin e strategjisë që vijon. Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet (SWOT) janë paraqitur më poshtë në këtë dokument.

Përparësitë	Dobësitë
Qendër e Regjionit-Komunë Ndërkufitarë (Kosovë, Serbi dhe Maqedoni e Veriut)	Kufizime buxhetore për realizim të projekte madhore infrastrukturore
Lehtësimet në regjistrimin e bizneseve të reja (shërbime efikase administrative)	Mungesa e zonave ekonomike
Popullatë e re edhe e arsimuar	Nivel i ulët i investimeve të huaja direkte
Njohurit e mira të rinisë në njohjen e gjuhës angleze, gjermane, turke, spanjolle – integrimi në tregun global.	Mos realizimi (përfundimi) i infrastrukturës rrugore/rrugët nacionale/rajonale
Ekzistimi i institucioneve të arsimit të lartë	
Kushtet e volitshme klimatike dhe boniteti i mirë i tokës.	Bizneset kryesisht të orientuara në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve dhe një numër i kufizuar në sektorin e prodhimit
Traditë shumëvjeçare në industrinë përpunuese – industria e ushqimit	
Qendra për Aftësim Profesional	
Potencialet natyrore për zhvillim të turizmit	
Gatishmëria e Komunës për dhënien e pronave publike në shfrytëzim afatgjatë	

Përvoja ne organizimin e panairove, eventeve kulturore, festivaleve dhe aktiviteteve të tjera që promovojnë ekonomin dhe trashëgiminë lokale.	
Mundësitë	Rreziqet
Krijimi i mundësi të reja për investime dhe hapjen e tregut pas finalizimit të autostrades Prishtinë - Gjiilan - Konçul Krijimi dhe funksionalizimi i zonës ekonomike Qasje ne fonde te BE, burime te financimit nga niveli qendror dhe donatore. Promovim i investime te huaja. Bashkëpunimi me diasporën për investime të përbashkëta (PPP) Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit privat përmes rritjes se subvencioneve sektorit te bujqësisë dhe ekonomisë (Start-up) Nxitja e politikave dhe lehtësimi kushteve për krijimit te bizneseve qe merren me Ekonomin Qarkore si dhe Krijimi i Fondit Komunal Mjedisor.	Largimi migrimi i kuadrit profesional Rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve nga viti ne vit ne te gjitha nivelet Mos interesim i donatoreve dhe investitorëve për te investuar

4.4 Përmbledhja e sfidave

[Sfidat në sektorin e Arsimit:] : Arsimi në Strategjinë e Zhvillim Ekonomik Lokal fuqitë e punës janë thelbësore për inovacionin dhe konkurrencën në treg. nënkupton themel të fuqishëm për rritjen ekonomike afatgjatë, pasi njohuritë dhe aftësitë e një

Sfidat themelore në sektorin e arsimit në Komunën e Gjilanit janë:

1. **Mungesa e infrastrukturës arsimore:** Shkollat dhe institucionet arsimore ende kanë nevojë për përmirësim dhe investime në infrastrukturë për të siguruar mjediset e përshtatshme mësimore.
2. **Mungesa e burimeve financiare:** Financimi i arsimit është një sfidë e vazhdueshme për shumë komuna, ende nevojiten investime të qëndrueshme për të siguruar pajisjet e nevojshme mësimore dhe trajnimin e pedagogëve.
3. **Mungesa e lidhjeve me industrinë:** Ndryshimet dhe inovacionet e shpejtë në teknologji dhe sektorët e tjerë ekonomikë kërkojnë lidhje të ngushta me industrinë për të siguruar qëndrimin e përshtatshëm të aftësive.

Për të adresuar këto sfida, një strategji për zhvillim ekonomik lokal mund të përfshijë:

- **Investime të përmirësimit të infrastrukturës arsimore:** Përmirësimi i ambienteve dhe investime në teknologji.
- **Ndihma financiare dhe fonde për arsim:** Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për të siguruar trajnimin dhe pajisjet e nevojshme.
- **Përmirësimi i programit dhe kurrikulave arsimore:** Përmirësimi i përgatitjes për gjuhën angleze dhe përdorimin e teknologjisë në mësim.
- **Bashkëpunim me industrinë dhe sektorin privat:** Krijimi i lidhjeve të forta me industrinë për të siguruar që programet arsimore të përgjigjen ndaj kërkesave të tregut të punës.

Nëse këto zbatohen me sukses, Komuna e Gjilanit mund të forcojë sektorin e arsimit dhe të përmirësojë bazën e njohurive dhe aftësive të nevojshme për të rritur zhvillimin ekonomik lokal afatgjatë.

[Sfidat në sektorin e Infrastrukturës:] | Sfida në sektorin e infrastrukturës në Komunën e Gjilanit mund të jenë:

1. **Mungesa e infrastrukturës bazë:** përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës si rrugët, ujësjellësit, kanalizimet, dhe infrastruktura e energjisë elektrike, kanë ndikim në aftësinë e bizneseve për të operuar me efikasitet .
2. **Mungesa e investimeve dhe burimeve financiare:** Financimi i projekteve të infrastrukturës është shpesh një sfidë, sigurimi i burimeve të nevojshme financiare është kritik për të zhvilluar infrastrukturën e nevojshme për rritjen ekonomisë lokale.
3. **Ruajtja dhe Menxhimi i mire i infrastrukturës ekzistuese:** Sigurimi i mirëmbajtjes dhe menaxhimit të infrastrukturës ekzistuese është po aq i rëndësishëm sa ndërtimi i re. Mungesa e planifikimit afatgjatë dhe menaxhimit të mirë mund të shkaktojë probleme në efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës.

Strategjitë për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Gjilanit në sektorin e infrastrukturës mund të përfshijnë:

- **Planifikim afatgjatë dhe strategjik:** Zhvillimi i planeve afatgjata për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës.
- **Bashkëpunim me sektorin privat dhe investitorët:** Krijimi i partneriteteve publike - private për financimin dhe zhvillimin e projekteve të infrastrukturës.
- **Përdorimi i teknologjisë dhe inovacionit:** Implementimi i teknologjisë së re dhe inovacionit në ndërtimin dhe menaxhimin e infrastrukturës për të përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë.
- **Përgjigje ndaj ndryshimeve mjedisore:** Planifikimi për të minimizuar impaktin e ndryshimeve mjedisore dhe natyrore në infrastrukturën ekzistuese dhe të re.

Synimi i fundit është përmirësimi i infrastrukturës fizike | i cili i ka disa objektiva si :

- Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit për ujërate zeza | përfundimi projektit Rregullimi i lumit Mirusha dhe Lumit Stanishorka
- Ndërtimi i gypit kryesor Penda e Përlepnicsë – Gjilan / Ø 600
- Ndërtimi i fabrikës për pastrimin e ujërave të zeza | impianti
- Ndërtimi i impiantit për djegien e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë!

Të gjitha këto objektiva do të ndikojnë në arritjen e synimit për një infrastrukturë moderne duke i realizuar disa nga projektet të cilat janë paraparë në kuadër të kësaj strategjie, si projekte me prioritet.

[Sfidat në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:] | Ky sektorë kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve.

Sfida e mundshme në këtë sektor janë:

1. **Mungesa e infrastrukturës shëndetësore:** Nevoja për investime për të siguruar kujdes të efektshëm të shëndetit dhe Mirëqenies Sociale
2. **Mungesa e personelit shëndetësor të kualifikuar:** Nevoja për rritje të kapaciteteve dhe trajnimeve për personelin shëndetësor, duke përfshirë infermierët, mjekët dhe stafin e mjekësisë së përgjithshme.
3. **Kujdesi shëndetësor:** trajtim i barabartë i grupeve të marginalizuara, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara për kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale.
4. **Financimi dhe burimet ekonomike:** Kosto e lartë e kujdesit shëndetësor dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet shëndetësore dhe shërbimet sociale.

Strategjitë për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Gjilanit në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale përfshijnë:

- **Investime në infrastrukturën shëndetësore:** Ndërtimi dhe përmirësimi i qendrave shëndetësore për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.
- **Trajnime dhe rritje e kapaciteteve për personelin shëndetësor:** Investime në trajnime për të ruajtur personelin shëndetësor të kualifikuar.
- **Promovimi i qasjes për grupet e marginalizuara:** Zhvillimi i programeve dhe politikave për të siguruar qasje të barabartë për kujdesin shëndetësor.
- **Bashkëpunim me organizata dhe sektorin privat:** Krijimi i partneriteteve me organizata jofitimprurëse dhe sektorin privat për të rritur burimet financiare për të ofruar shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

[Sfidat në sektorin e Bujqësisë, Ekonomisë dhe Zhvillimit Rural:] sfida të rëndësishme që Komuna e Gjilanit mund të përballet me to janë:

1. Nevoja për investime në infrastrukturën bujqësore, si rrugët bujqësore, ujësjellësit, sistemet e drenazhit – lumi Morava për të përmirësuar kushtet e prodhimit bujqësor.
2. Nevoja për trajnime dhe përdorimin e teknologjisë së avancuar në bujqësi për të rritur produktivitetin dhe për të përdorur më efikas teknikat bujqësore.
3. Kostoja e lartë e kapitalit dhe mungesa e qasjes në kredinë bujqësore për të financuar investimet në prodhim dhe modernizimin e fermave.
4. Çështjet e pronësisë tokësore dhe administrimi i tokës, duke përfshirë probleme me administrimin e tokës dhe ndarjen e saktë të tokës për prodhim bujqësor.
5. Nxitja e politikave dhe lehtësimi kushteve për krijimit të bizneseve që merren me Ekonomin Qarkore si dhe Krijimi i Fondit Komunal Mjedisor
6. Promovimi i komunitetit të biznesit – ekonomisë lokale
7. Konkurenca jolojale
8. Inflacioni
9. Importi i produkteve

Strategjitë për zhvillim ekonomik lokal në sektorin e bujqësisë, ekonomisë dhe zhvillimit rural në Komunën e Gjilanit mund të përfshijnë:

- Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për të përmirësuar qasjen dhe efikasitetin në prodhimin bujqësor.
- Inkurajimi i praktikave bujqësore të qëndrueshme për të reduktuar ndikimin në mjedis dhe për të rritur prodhimtarinë me metoda më të efikashta.
- Sigurimi i trajnimeve dhe përdorimi i teknologjisë së avancuar në bujqësi për të rritur produktivitetin dhe për të përmirësuar praktikat bujqësore.
- Krijimi i programeve dhe iniciativave për të lehtësuar aksesin në kredi dhe financime për fermerët për investime të nevojshme në bujqësi.
- Rishikimi i politikave dhe procedurave për administrimin e tokës dhe për të adresuar çështjet e pronësisë dhe administrimit të tokës bujqësore.
- Kalimi nga Ekonomia Lineare në Ekonomin Qarkore (Nxitja e politikave dhe lehtësimi kushteve për krijimit të bizneseve që merren me Ekonomin Qarkore si dhe Krijimi i Fondit Komunal Mjedisor që ka për qëllim mbrojtën e mjedisit dhe pyllëzimin e sipërfaqeve të reja | Tranzicioni kah Ekonomia e Gjelbër
- Organizmi i panairëve dhe eventeve ekonomike : ngjarjet e tilla ofrojnë platforma të rëndësishme për tregtinë, promovimin e produkteve vendase.

[Sfidat në sektorin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore:] | disa nga sfidat janë :

1. Nevoja për investime në infrastrukturën turistike, si akomodimet, restorantet, infrastruktura e rrugëve dhe shërbime të tjera turistike | nxitja e sektorit privat
2. Nevoja për strategji të qarta të marketingut dhe promovimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e turistëve për të vizituar Komunën e Gjilanit
3. Nevoja për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore lokale, duke përfshirë monumente historike, traditat, artin dhe kulturën lokale.
4. Nevoja për zhvillimin e aftësive dhe trajnimeve për personelin e turizmit dhe shërbimet për të siguruar një shërbim cilësor dhe miqësor për vizitorët.
5. Nevoja për të siguruar që përfitimet nga turizmi të shpërndahen në komunitetin lokal dhe që të krijojnë mundësi të reja të punësimit dhe të biznesit lokal.

Mundësitë në sektorin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore:

1. **Përdorimi i potencialeve natyrore dhe kulturore:** peizazhet natyrore të bukura, siç janë Malet e Karadakut, traditat unike të Gjilanit.
2. **Zhvillimi i turizmit rural dhe agroturizmit si dhe Organizimi i eventeve kulturore dhe festivaleve:** Inkurajimi i turizmit rural dhe agroturizmit për të promovuar bujqësinë vendase, si dhe organizimi i eventeve kulturore...
3. **Partneritetet dhe bashkëpunimet:** Krijimi i partneriteteve operatorët lokalë dhe organizatat kulturore për të zhvilluar produkte turistike inovative.
4. **Investimet në trajnime dhe zhvillim të kapaciteteve:** Investime për të përmirësuar aftësitë e personelit të turizmit dhe shërbimeve të tjera turistike.

Strategjitë për zhvillim ekonomik lokal në sektorin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore:

- **Zhvillimi i një plani të marketingut dhe promovimit:** Krijimi i një strategjie të qartë për të promovuar destinacionin turistik të Gjilanit në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.
- **Turizmit rural dhe agroturizmit:** Zhvillimi i produkteve dhe paketave turistike për të promovuar bujqësinë dhe kulturën bujqësore lokale.
- **Rishikimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore:** Mbrojtja dhe promovimi i monumenteve historike dhe kulturës së pasur të Gjilanit për të mbështetur zhvillimin e turizmit kulturor.
- **Bashkëpunimi dhe partneritetet:** Krijimi i partneriteteve dhe bashkëpunimeve me sektorin privat, organizatat e turizmit dhe autoritetet lokale për të realizuar iniciativa të përbashkëta dhe për të rritur përfshirjen në sektorin e turizmit

V. Objektivat | ARSIMI

7.1 Objektiva e përgjithshme 1: Avancimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet

Arsyetim : Duke përmirësuar cilësinë e arsimit nga arsimi parauniversitar deri në atë universitar dhe profesional, krijohen mundësi të reja për individët dhe kontribuohet në formimin e qytetarëve të kualifikuar, të gatshëm për të përballuar sfidat e shekullit XXI.

7.1.1 Objektiva specifike 1: Arsimimi i nxenesve sipas nevojave të tregut të punës

7.1.1.1 Aktiviteti1 : Rritja e numrit të rinjve për të hyrë në tregun e punës dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet

7.1.1.1.1 Aktiviteti 2. Identifikimi i profileve të nevojshme profesionale në bashkëpunim me komunitetin e biznesit

7.1.2 Objektiva specifike 2: Avancimi i bashkëpunimit me komunitetin

7.1.2.1 Aktiviteti 1: Themelimi i këshillave të shkollave dhe këshillit komunal të prindërve dhe Hartimi i kalendarit vjetor të takimeve

7.1.2.1.1 Aktiviteti 2. Rritja e buxhetit të bursave për studentë

7.1.3 Objektiva specifike 3: Edukimi në fëmijërinë e hershme

7.1.3.1 Aktiviteti 1 : Ndërtimi i objekteve të çerdheve dhe institucioneve parashkollore

7.1.3.1.1 Aktiviteti 2. Ndërtimi i objektit të Shkolles së Mesme të Mjekësisë dhe Furnizimi me pajisje të nevojshme

7.1.3.1.2 Aktiviteti : Pajisja e të gjitha klasave me tabela SMART dhe krijimi i këndeve të lodrave dhe rekreacionit

Objektivat | INFRASTRUKTURA

7.2 Objektiva e përgjithshme 1: Përmirësimi i infrastrukturës publike

Arsyetimi: Përmirësimi i infrastrukturës publike është thelbësor për rritjen e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin ekonomik. Kjo ndihmon në lehtësimin e qasjes në shërbime të ndryshme, rritjen e efikasitetit të transportit dhe komunikimit, dhe krijimin e kushteve më të mira për bizneset dhe qytetarët.

7.2.1 Objektivi Specifik 1: Funkcionalizmi dhe modernizimi i qendres se qytetit

7.3.1.1 Aktiviteti 1 : Ndërtimi i integruar të Bulevardit të Qytetit – Gjilan

7.3.1.2 Aktiviteti 2: Përmirësimi i infrasturkures rrugore

7.2.2 Objektivi Specifik 2: Shkarkimi i trafikut brenda zonës së qytetit

7.2.2.1 Aktiviteti1 : Rregullimi i infrasturkures ne zonen e pare

7.2.2.2 Aktiviteti 1. Rregullimi i infrasturkures ne zonen e tretë

7.2.3 Objektiva specifike 3 : Revitalizimi dhe ndertimi i infrastruktures se re rrugore

7.2.3.1 Aktiviteti 1: Infrastrukturë rrugore në fshatra dhe qytet

7.2.3.1.1 Aktiviteti 1: Hapesira te reja te gjelberta publike te krijuara

VI. Objektivat | SHËNDETSIA

7.5 Objektiva e përgjithshme 3: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale

Arsyetimi: Objektivi i këtij plani është përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sistemeve të mirëqenies sociale, duke siguruar qasje më të gjerë, cilësi më të lartë dhe akses të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht statusit ekonomik ose gjeografik.

7.5.1 Objektiva specifike 1 - Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore

7.5.1.1 Aktiviteti1: Zgjerimi i shërbimeve shëndetësore dhe rregullimi i hapësirave të jashtme të institucione shëndetësore

7.5.1.2Aktiviteti 2:- Ndërtimi i pjerrinave apo ashensorëve për PAK (Personat me Aftësi të Kufizuar)

7.5.2 Objektiva specifike 2 - Përmirësimin e kushteve në ofrimin e shërbimeve sociale – mbrojtja e fëmijëve dhe te moshareve

7.5.2.1 Aktiviteti 1: Ndertimi i shtepive per mbrojtjen e femijeve (SHEMF)

7.5.2.2 Aktiviteti 2: Ndërtimi i shtëpive të komunitetit për persona të Moshuar (SHKPM)

7.5.3 Objektiva specifike 3 - Përmirësimin e kushteve në ofrimin e shërbimeve sociale

7.5.3.1 Treguesi 1: Realizim efikas i thirrjes publike për OJQ për përmirësimin e shërbimeve sociale

7.5.3.2 Aktiviteti 2: Monitorimi i projekteve të financuar nga fondet e Drejtorisë së Shëndetësisë

VII. Objektivat | BUJQËSIA, ZHVILLIMI RURAL DHE EKONOMIA

7.7 Objektiva e përgjithshme : Zhvillim i metejshe i bujqësisë, zhvillimit rural

Arsyetim : Objektivat e përgjithshme të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural janë thelbësore për përmirësimin e kushteve të jetesës, rritjen e prodhimit dhe sigurisë ushqimore, si dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të zonave rurale.

7.7.1 Objektiva specifike 1: Përmirësimi i infrastruktures së metejshe për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural

7.7.1.1 Aktiviteti 1: Rritja e rendimentit bujqësor

7.7.1.2 Aktiviteti 1: Hapja e rrugëve të arave

7.7.2 Objektiva specifike 2: Menaxhimi i qeneve endacakë

7.7.2.1 Aktiviteti 1: Grumbullimi dhe vendosja e qeneve në strehimore

7.7.2.2 Aktiviteti 2: Menaxhimi i strehimores së qeneve

7.7.3 Objektiva specifike 3: Subvencionimi i sektorit të bujqësisë

7.7.3.1 Aktiviteti 1: Komunikimi me komunitetin e fermerëve dhe analiza e kërkesave

7.7.3.2 Aktiviteti 2: Menaxhimi i subvencioneve dhe bashkëpunimi me MBZHR

7.8 Objektiva e përgjithshme : Zhvillimi Ekonomise Lokale

Arsyetim : Zhvillimi i ekonomisë lokale ka për qëllim rritjen e nivelit të jetesës për qytetarët, duke siguruar një ekosistem të qëndrueshëm dhe të balancuar që mund të mbështesë rritjen e konkurrencës dhe diversifikimin e aktiviteteve ekonomike.

7.8.1 Objektiva specifike 1 : Permiresimi i infrastruktures biznesore

7.8.1.1 Aktiviteti: Rregullimi i infrastrukturës ne sipërfaqja e ndarë e Zonës Ekonomike prej 146.5 hektarë

7.8.1.2 Aktiviteti 1: Inkubatori i Biznesit – TIK

7.8.1.3 Aktiviteti 2: Promovimi i Agjendes se gjelber dhe ekonomise qarkore

7.8.2 Objektiva specifike 2 : Rritja e punesimit permes zhvillimit te sektorit privat

7.8.2.1 Aktiviteti 2: Krijimi i vendeve te reja te punes

7.8.2.2 Aktiviteti 1: Mbeshtetje bizneseve me plan zgjerimi duke ofruar prone publike ne shfrytëzim

7.8.3 Objektiva specifike 3 : Identifikimi dhe realizimi i projekteve me PPP dhe zhvillimin e bizneseve Start-up dhe organizimi i panaireve

7.8.3.1 Aktiviteti 1: Mbeshtetje financiare për zhvillimin e bizneseve Start-up dhe bizneset e grave

7.8.3.2 Aktiviteti 2 : Organizmi i panaireve dhe promovimi i bizneseve si dhe pjesëmarrja ne panaire

8 Monitorimi dhe Raportimi

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik do të luaj një rol kyç në sigurimin e një procesi të strukturuar dhe të qëndrueshëm për monitorimin dhe raportimin e strategjisë, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të zhvillimit ekonomik lokal.

Me qëllim të monitorimit do të ndermerren veprimet si me poshte:

- Do të monitorohet avancimi drejt qëllimeve dhe objektivave të strategjisë.
- Do të evidentohen sfidat dhe pengesat që dalin gjatë zbatimit.
- Do të rishikon dhe përditëson indikatorët në përputhje me ndryshimet në prioritetet lokale.

Monitorimi është një aspekt shumë i rëndësishëm për sigurinë e suksesit dhe zbatimin efektiv të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026-2031. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik do të ketë rolin kryesor në udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të monitorimit, duke siguruar që të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara të realizohen sipas planifikimeve dhe objektivave të vendosura.

Ky proces do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë e tjera komunale dhe Komitetin për Zhvillim Ekonomik, të cilat do të kontribuojnë në mbledhjen e të dhënave relevante dhe analizën e progresit në fushat e ndryshme të zhvillimit ekonomik, si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe trashigimia kulturore .

Për të garantuar transparencën dhe rendimentin e strategjisë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik do të përgatisë një raport vjetor të detajuar, që do të përmbledhë rezultatet, sfidat, dhe mundësitë e reja të krijuara gjatë vitit. Ky raport do të paraqitet në Kuvendin Komunal në baza vjetore, duke ofruar mundësinë për vlerësimin dhe diskutimin publik të arritjeve dhe mangësive, si dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm.

Proces i monitorimit është esencial për të siguruar që strategjia të mbetet fleksibël dhe e adaptueshme ndaj ndryshimeve të mundshme në mjedisin ekonomik dhe social, duke mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm dhe arritjen e qëllimeve të zhvillimit afatgjatë të komunitetit. Monitorimi do të bëhet në baza vjetore ndërsa rishikimi i Planit të Veprimt do të bëhet në baza 3-vjeçare.

9 Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor

Buxheti është një plan financiar që përfshin të ardhurat dhe shpenzimet e Komunës së Gjilanit për një periudhë të caktuar, zakonisht një vit fiskal i cili fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor.

Komuna e Gjilanit është njësi administrative dhe territoriale e qeverisjes lokale dhe ka përgjegjësi për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve publike në nivel lokal Komuna planifikon dhe menaxhon buxhetin e saj në përputhje me të ardhurat vetanake dhe transferet e grantit qeveritar të alokuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ministria e Financave e mbikëqyr dhe koordinon politikat dhe financat ndërmjet komunave dhe nivelit qendror për të siguruar një zhvillim të balancuar dhe efikas të vendit.

Përshkrimi dhe Emërtimet	Vitet - Ndikimi Buxhetor		
	Viti 1	Viti 2	Viti 3
	2026	2027	2028
Përmbledhje e kostove të Strategjisë			
Mbështetja e zotuar me ekspertë			
Mbështetja e zotuar buxhetore (e harmonizuar me KAB (2026-2028))	41,928,925	44,340,057	46,402,501
Mundësi potenciale financimi nga donatorët			
Buxheti i Kosovës			

Tabela : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 – 2028)

Përshkrimet / emërtimet	2026	2027	2028
Totali €	41,928,925	44,340,057	46,402,501

Buxheti komunal per vitin 2026 është si në vijim:

Tabela :

Përshkrimet / emërtimet	Viti 2026
Granti i përgjithshëm	16,408,177.00
Granti i Shëndetësisë	4,317,011.00
Granti i Arsimit	14,741,775.00
Të hyrat vetanake	5,821,202.00
Financimi i Teatrove	338,259.00
Financimi për shërbime rezidenciale	302,500.00
Totali €	41,928,924.00

Ndarja buxhetore e Komunes se Gjilanit sipas kategorive per vitin 2026 sipas kategorive buxhetore eshte siq eshte paraqitur ne tabelen e meposhtme.

Përshkrimet / emërtimet	Viti 2026
Pagat dhe mëditjet	23,196,167
Mallra dhe shërbimet	8,953,332
Shpenzimet komunale	683,700
Subvencionet	2,238,727
Shpenzimet kapitale	6,856,999
Totali €	41,928,925.00

Sipas qarkores buxhetore për periudhën 2026–2028, të miratuar dhe të përcaktuar nga Ministria e Financave, janë vendosur kufijtë buxhetorë për komunat, përfshirë edhe Komunën e Gjilanit, në kuadër të planifikimit afatmesëm fiskal dhe stabilitetit financiar publik.

Këto projeksione të përcaktuara nga Ministria e Financave reflektojnë një qasje të qëndrueshme të planifikimit fiskal dhe një trend pozitiv të rritjes së mbështetjes buxhetore për nivelin lokal, duke i mundësuar Komunës së Gjilanit vazhdimësi në realizimin e projekteve zhvillimore dhe ofrimin e shërbimeve publike më cilësore për qytetarët.

Ndikimi Buxhetor në Hartimin e Strategjisë të Zhvillimit Ekonomik Lokal

Ndikimi buxhetor në hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën 2026–2028, sipas kornizës së përcaktuar nga Ministria e Financave, tregon një trend të qëndrueshëm dhe pozitiv të rritjes së kapaciteteve financiare të Komunës së Gjilanit.

Buxheti total rritet nga 41,928,924 € në vitin 2026, në 44,340,056 € në vitin 2027 dhe arrin në 46,402,501 € në vitin 2028, duke reflektuar një zgjerim gradual të mundësive fiskale të komunës. Rritja vërehet si në grantet kryesore (arsimi, shëndetësia dhe granti i përgjithshëm), ashtu edhe në të hyrat vetanake dhe shpenzimet kapitale, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal.

Në veçanti, rritja e investimeve kapitale tregon orientimin drejt projekteve zhvillimore, infrastrukturës dhe përmirësimit të shërbimeve publike. Në përgjithësi, kjo kornizë buxhetore krijon kushte të favorshme për zbatimin e politikave zhvillimore dhe tregon një trend pozitiv të avancimit ekonomik të komunës së Gjilanit.

Tabela :

Përshkrimet	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Granti i Përgjithshëm	16,408,177	17,677,278	19,100,845
Granti i Shëndetësisë	4,317,011	4,446,521	4,579,917
Granti i Arsimit	14,741,775	15,184,028	15,639,549
Te hyrat vetanake	5,821,202	6,260,365	6,290,699
Financimi i teatrove	338,259	356,864	376,491
Financimi për shërbime rezidenciale	302,500	415,000	415,000
Totali €	41,928,924	44,340,056	46,402,501

Struktura e shpenzimeve buxhetore për periudhën 2026–2028 në Komunën e Gjilanit tregon një planifikim të balancuar mes funksionimit të administratës dhe investimeve zhvillimore, në përputhje me kornizën e përcaktuar nga Ministria e Financave.

Tabela :

Përshkrimet	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Pagat dhe mëditjet	23,196,167	23,312,148	23,428,708
Mallrat dhe shërbimet	8,953,332	9,293,008	9,630,719
Shpenzimet komunale	683,700	720,171	751,632
Subvencione	2,238,727	2,399,714	2,195,265
Shpenzime Kapitale	6,856,999	8,615,016	10,396,177
Totali €	41,928,925	44,340,057	46,402,501

Pjesa më e madhe e buxhetit shkon për **pagat dhe mëditjet**, që mbetet kategoria kryesore për funksionimin e shërbimeve publike. Një pjesë e konsiderueshme është e dedikuar për **mallra dhe shërbime**, si dhe për **shpenzime komunale**, të cilat sigurojnë funksionimin e rregullt institucional.

Një rol veçanërisht të rëndësishëm kanë **subvencionet**, të cilat përbëjnë një instrument kyç në zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Në këtë kategori përfshihen:

- fondi për subvencionimin e bizneseve start-up dhe bizneseve të grave,
- fondi për subvencionimin e fermerëve,
- fondi për subvencionimin e nxënësve dhe studentëve përmes bursave,
- si dhe fondi për subvencionimin e OJQ-ve për projekte atraktive zhvillimore.

Këto masa kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e ndërmarrësisë, fuqizimin e sektorit rural, mbështetjen e arsimit dhe inkurajimin e shoqërisë civile, duke kontribuar në zhvillim më gjithëpërfshirës ekonomik dhe social.

Në tërësi, rritja e shpenzimeve kapitale dhe përdorimi strategjik i subvencioneve tregojnë një orientim të qartë drejt zhvillimit afatgjatë të komunës së Gjilanit dhe forcimit të ekonomisë lokale.

Në përgjithësi, kjo strukturë buxhetore pasqyron një qasje zhvillimore, ku subvencionet dhe investimet kapitale shërbejnë si shtylla kryesore për realizimin e objektivave të strategjisë ekonomike lokale.

INVESTIMET KAPITALE 2026 - 2031

Nr.	Emri dhe përshkrimi i projektit	Kosto në €	Burimi i Financimit			Vitet – periudha e financimit					
			Komuna	Qeveria	Donatorët	2026	2027	2028	2029	2030	2031
01.	Ndërtimi i objektit të Administratës komunale	4,620,489	✓		✓						
02.	Ndërtimi i objektit të Shkollës së Mesme të Mjeksisë	2,600,000	✓	✓	✓						
03.	Ndërtimi i stacionit të Autobusëve	1,136,010	✓	90,000	✓						
04.	Përfundimi i shartit të lumit Stanishorka dhe asfaltimi i rrugës "Hamdi Kurteshi"	2,365,834	✓	✓	✓						
05.	Subvencionimin e Bizneseve Start-up dhe bizneset e grave	2,970,000	✓								
06.	Projekte për rritjen e potencialit ekonomik dhe turistik	1,875,000	✓	✓	✓						
07.	Zona Ekonomike – zhvillimi i infrastrukturës	9,235,000	✓	✓							
08.	Projekte të zhvillimit të mjedisit	845,000	✓	✓							
09.	Ndërimi i Inkubatorit të Biznesit (Qendra Inovative)	6,240,000	✓	✓							
10.	Kult - Qendra, përfundimi i projektit	1,186,511	1,056,511	130,000							
11.	Palestra e sporteve "Bashkim Selishta" Gjilan	2,400,000	400,000	2,000,000							
12.	Kompletimi i infrastrukturës për varresat e reja të qytetit	3,200,00	✓	✓							
13.	Projekti Smart City (Neutral Host)	450,000	200,000	250,000							
14.	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza-Gjilan	3,125,014	✓	3,125,014							
15.	Asfaltimi Rrugës në fshatin Kokaj (Ruga Llovçë -Ranatoc)	569,135.37	✓	✓							
16.	Përfundimi i Asfaltimit të rrugëve në fshatin Malishevë e Ulët I Faza-II	191,645	99,452	92,193							
17.	Asfaltimi rrugëve "Jonuz Tërstena" dhe "28 Nëntori" Krahët 1-5	266,709	99,999	166,710							
18.	Asfaltimi rrugëve "Qefserë Salihu" dhe "Blerim Halili"	299,932	129,999	169,933							

19.	Asfaltimi Rrugëve ne lagjen Livadhet e Arapit	250,100	99,999	150,101							
20.	Rruga “Nëna Tereza” Gjilan	512,625	200,000	312,625							
21.	Subvencionimin i sektorit te Bujqësisë dhe Blegtorisë	2,970,000									
22.	Kanalizim fekal Livoq i Ulet Livoq i Epërm dhe një pjese e Kodrës se Thate	455,610	41,811	413,799							
23.	Asfaltimi i rrugës Malishevë – Verbicë e Kmetocit	258,659.80	258,659.80	✓							
24.	Qëndrimi Ditor për të Moshuarit Bujtinë për Studentë, Kuzhinë Humanitare	2,500,000	✓								
25.	Humanizmi i hapësirave publike, rrugë dhe trotuareve, parqe dhe kopshte (kalimi nga linjat e hapura ajrore ne gypa nëntokësor largimi i të gjitha shtyllave elektrike – te linjave elektrike te tensionit te lartë, tensionit te ulet si dhe linjave te postes dhe internetit)	7,897,421	✓	✓							
26.	Ndërtimi i projektit të integruar të Bulevardit të Qytetit - Gjilan	7,000,000	✓	✓							
27.	Ndërtimi i gypit kryesor Penda e Përlepnicës – Gjilan / Ø 600	3,750,000	✓	✓							
28.	Rregullimi i rrjetit kryesor te kanalizimit dhe shtratit te lumit Zhegër - Lladovë	2,750,000	✓	✓							
29.	Rregullimi i shtratit te lumit Cernicë – rruga kryesore Gjilan - Ferizaj	1,250,000	✓	✓							
30.	Përfundimi i projektit : Ndërtimi i platosë mbi lumin e Mirushës	390,000	✓								
31.	Realizmi i projekteve per mes programit Masave Efiçente objekteve publike komunale dhe banesave kolektive	4,735,963	✓	✓							
32.	Ekonomi Qarkore - Nxitja e politikave dhe lehtësimi kushteve per zhvillim	630,000	✓	✓							
33.	Krijimi i Fondit Komunal Mjedisor	230,000	✓	✓							

34.	Promovimi i komunitetit e biznesit – ekonomisë lokale organizimi i panairove lokale dhe pjesëmarrja ne panairove nderkombëtare	188,321	✓	✓							
35.											
36.											

Vërejtje :

Grupet parlamentare të përfaqësuesve në Kuvendin Komunal të Gjilanit kanë mundësinë dhe të drejtën të propozojnë projekte të reja, duke përfshirë të gjitha sektorët kyç të qytetit dhe fshatrave.

Kjo nismë ka si qëllim të fuqizojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të shpejtojë progresin e komunës në dekadën e re që po vjen.

I. Plani i Veprimit

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2026-2027

Objektivi i përgjithshëm 1: Avancimi i sistemit arsimor ne te gjitha nivelet						
Objektivi specifik 1.1 Arsimimi i nxenesve sipas nevojave te tregut te punes	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Rritja e numrit te te rinjeve per te hyre ne tregun e punes			Gjendja bazë (10%)	Caku 2026 30%	Caku 2027 75%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna, duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1) Rritja e numrit te te rinjeve per te hyre ne tregun e punes dhe permiresimi i infrastrukturës fizike të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet	2026 2027	75,000 100,000	Buxheti komunal	DKA	MASHT	Infrastruktura fizike të sistemit të arsimit
2) Identifikimi i profileve te nevojshme profesionale ne bashkëpunimi me komunitetin e biznesit	2026 2027	35,000 100,000	Buxheti komunal	DKA	MASHT	Analiza e tregut, studimi i mundësive per rinin
Objektivi specifik 1.2 Avancimi i bashkëpunimit me komunitetin	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Në periudhe 12-mujore, do te përfshihen pjesëmarrje e të paktën 13 organizatave jo qeveriare dhe grupe qytetare			Gjendja bazë (20%)	Caku 2026 55%	Caku 2027 85%

Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1) Themelimi i këshillave të shkollave dhe këshillit komunal të prindërve dhe Hartimi i kalendarit vjetor të takimeve	2026 2027	13,000 14,500	Buxheti komunal	DKA	MASHT	Krijimi një urë lidhëse më të fortë mes prindër/shkollë
2) Krijimi i buxhetit të bursave për studentë	2026 2027 2028	80,000 120,000 150,000	Buxheti komunal	DKA	MASHT	Ndihmon në përballimin e kostove të arsimit
Objektivi specifik 1.3 Edukimi në fëmijërinë e hershme	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Përfshirja e 90% e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç të regjistruar në programe edukative për fëmijërinë e hershme brenda një viti.			Gjendja bazë (30%)	Caku 2026 75%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1) Ndërtimi i objekteve të çerdheve dhe institucioneve parashkollore	2026 2027	200,000 370,000	Buxheti komunal	DKA	MASHT	Qasjes në arsim parashkollor.
2. Ndërtimi i objektit të Shkolles së Mesme të Mjekësisë dhe Furnizimi me pajisje të nevojshme	2026 2027	2,310,241 2,310,241	Buxheti komunal	DKA	MASHT	Përmirësimi i cilësisë së arsimit në fushën e mjekësisë.

3	Pajisja e të gjitha klasave me tabela SMART dhe krijimi i këndeve te lodrave	2026	370,500	Buxheti komunal	DKA	MASHT	Angazhimit dhe motivimit të nxënësve.
		2027	400,000				
Objektiva e përgjithshme 2: Permiresimi i infrastrukturës							
Objektivi Specifik 2.1: Funksionalizmi dhe modernizimi i qendres se qytetit	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Infrastrukturë moderne – Bulevardi i qytetit - brenda periudhes 2026 - 2028				Gjendja bazë (30%)	Caku 2026 65%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati	
1) Ndërtimi i integruar të Bulevardit të Qytetit – Gjilan	2026	3,765,000	Buxheti komunal	DSHPI	MMPH	500 parkingje, duke e përfshirë edhe nënkalimin,	
	2027	7,232,500					
	2028	7,232,500					
2) Përmirësimi i infrsturkures rrugore	2026	74,000	Buxheti komunal	DSHPI	MMPH	Siguria dhe efikasitetit të transportit	
	2027	100,000					
Objektivi Specifik 2.2: Shkarkimi i trafikut brenda zonës së qytetit	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit brenda zonës së qytetit me 75% gjatë orëve të pikut brenda periudhes 2026-2028				Gjendja bazë (30%)	Caku 2026 65%	Caku 2027 100%

Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1.Rregullimi i infrasturktures ne zonen e pare te qytetit	2026 2027	2,500,000 4,500,000	Buxheti komunal	DSHPI	MMPH	Akses në shërbime te mira
2) Rregullimi i infrasturktures ne zonen e tretë te qytetit	2026 2027	74,000 100,000	Buxheti komunal	DSHPI	MMPH	Lidhje të mira me pjesët e tjera të qytetit
23 Objektiva specifike 3 : Revitalizimi dhe ndertimi i infrastruktures se re rrugore	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Asfaltimi i 35 km rruge brenda periudhes 2026-2027			Gjendja bazë (30%)	Caku 2026 75%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1.Infrastrukturë rrugore në fshatra dhe qytet	2026 2027	300,000 354,000	Buxheti komunal	DSHPI	MMPH	Rritja e mobilitetit
2) Hapesira te reja te gjelberta publike te krijuara	2026 2027	60,000 100,000	Buxheti komunal	DSHPI	MMPH	Mundësi për rekreacion
Objektiva e përgjithshme 3: Permiresimi i sherbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale						

Objektiva specifike 3.1 - Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit QKFM e pajisurë me teknologji moderne per vitet 2026-2027			Gjendja bazë (10%)	Caku 2026 45%	Caku 2027 87%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1)Zgjerimi i shërbimeve shëndetësore dhe rregullimi i hapësirave të jashtme të institucione shëndetësore	2026 2027	80,000 131,000	Buxheti komunal	QKMF	MSH	Kushteve më të mira për pacientët dhe stafin.
2) Ndërtimi i pjerrinave apo ashensorëve për PAK (Personat me Aftësi të Kufizuar)	2026 2027	30,000 55,000	Buxheti komunal	QKMF	MSH	Garantimin e aksesit të barabartë
Objektiva specifike 3.2 - Përmirësimin e kushteve në ofrimin e shërbimeve sociale – mbrojtja e fëmijëve dhe të moshaveve	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë (10%)	Caku 2026 35%	Caku 2027 75%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati

1)Ndertimi i shtepive per mbrojtjen e femijeve (SHEMF)	2026	50,000	Buxheti komunal	QKMF	MSH	Mbështetje për fëmijët që janë viktima të abuzimeve
	2027	161,000				
2) Ndërtimi i shtëpive të komunitetit për persona të Moshuar (SHKPM)	2026	30,000	Buxheti komunal	QKMF	MSH	Për dinjitetin e tyre.
	2027	55,000				
Objektiva specifike 3.3 - Përmirësimin e kushteve në ofrimin e shërbimeve sociale	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit 95% e fëmijëve dhe e personave të moshuar do përfitojnë nga shërbime mbrojtëse dhe sociale			Gjendja bazë (0%)	Caku 2026 35%	Caku 2027 75%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1)Realizim efikas i thirrjes publike për OJQ per përmirësimin e shërbimeve sociale	2026	15,000	Buxheti komunal	QKMF	MSH	Rritja e angazhimit komunitar për shërbimeve cilësore
	2027	22,000				
2) : Monitorimi i projekteve të financuar nga fondet e Drejtorisë së Shëndetësisë	2026	10,000	Buxheti komunal	QKMF	MSH	Për sigurimin e transparencës dhe efikasitetit
	2027	16,000				
2) Realizim efikas i thirrjes publike për OJQ per përmirësimin e shërbimeve sociale	2026	20,000	Buxheti komunal	QKMF	MSH	Inovacionit dhe aksesit më të mirë në shërbime për grupe të caktuara.
	2027	43,000				
Objektiva e përgjithshme 4 : Zhvillim i metejshem i bujqësisë, zhvillimit rural						

Objektiva specifike 4.1: Permirësimi i infrastrukturae se meteishme per zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Investime në infrastrukturën bujqësore dhe rurale të realizuara do të kenë 45% e fernereve			Gjendja bazë (10%)	Caku 2026 55%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtorja udhëheqës	Drejtorja mbështetës	Rezultati
1) Rritja e rendimentit bujqësor / subvencionimi	2026 2027	500,000 1,250,000	Buxheti komunal	DBZHR	MBZHR	Ushqimit të mjaftueshëm
2) Hapja e rrugëve te arave	2026 2027	170,000 300,000	Buxheti komunal	DBZHR	MBZHR	Qasjes në tokat bujqësore,
Objektiva specifike 4.2: Menaxhimi i qeneve endacakë	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Do të menaxhohen dhe do të regjistrohen 100% e qeneve endacak rregulloreve të përcaktuara.			Gjendja bazë (10%)	Caku 2026 55%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtorja udhëheqës	Drejtorja mbështetës	Rezultati
1) Grumbullimi dhe vendosja e qeneve ne strehimore	2026 2027	100,000 266,000	Buxheti komunal	DBZHR	MBZHR	Sigurinë e komunitetit
2) Menaxhimi i strehimores se qeneve	2026 2027	40,000 100,000	Buxheti komunal	DBZHR	MBZHR	Sigurinë e komunitetit

Objektiva specifike 4.3: Subvencionimi i sektorit te bujqesis dhe zhvillimit rural	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit 750 fermerë do përfitojne nga subvencione sipas planit të miratuar.			Gjendja bazë (10%)	Caku 2026 55%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1)Komunkimi me komunitetin e fermerëve dhe analiza e kërkesave	2026	12,000	Buxheti komunal	DBZHR	MBZHR	Komunikimi me komunitetin e fermerëve rritin produktivitetin.
	2027	19,000				
2) Menaxhimi i subvencioneve dhe bashkëpunimi me MBZHR	2026	10,000	Buxheti komunal	DBZHR	MBZHR	
	2027	17,000				
Objektiva e përgjithshme 5 : Zhvillimi Ekonomise Lokale						
5.1 Objektiva specifike 1 : Permiresimi i infrastruktures biznesore	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Rritja e aksesit në tregje dhe përmirësimin e kushteve për investime të huaja dhe vendase.			Gjendja bazë (0%)	Caku 2026 55%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1)Rregullimi i infrastrukturës ne sipërfaqja e ndarë e Zonës Ekonomike prej 146.5 hektarë	2026	5,000.000	Buxheti komunal	DZHE	MINT	Krijohen kushte të favorshme për investime dhe rritjen e aktivitetit ekonomik
	2027	8,750,000				

2) Inkubatori i Biznesit – TIK	2026	2,000,000	Buxheti komunal	DZHE	MINT	Mbështetje të start-up-eve
	2027	5,600,000				
3)Promovimi i Agjendes se gjelber dhe ekonomise qarkore	2026	30,000	Buxheti komunal	DZHE	MMPH	Thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e mjedisit
	2027	60,000				
Objektiva specifike 5.2 : Rritja e punesimit permes zhvillimit te sektorit privat	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Kjo objective kontribuon në uljen e papunësisë dhe përmirësimin e kushteve ekonomike, duke ndihmuar gjithashtu në rritjen e produktivitetit dhe stabilitetit social.			Gjendja bazë (20%)	Caku 2026 65%	Caku 2027 100%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1)Krijimi i vendeve te reja te punes / subvencionimi	2026	150,000	Buxheti komunal	DZHE	MINT	Uljen e papunësisë,
	2027	300,000				
2)Mbeshtetje bizneseve me plan zgjerimi duke ofruar prone publike ne shfrytëzim	2026	40,000	Buxheti komunal	DZHE	MMPH	Krijimin e mundësive të reja
	2027	70,000				
Objektiva specifike 5.3 : Identifikimi dhe realizimi i projekteve me PPP dhe zhvillimin e bizneseve Start-up dhe organizimi i panaireve	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit Objektiv fokusohet në nxitjen e partneriteteve publike-private (PPP) dhe mbështetje për bizneset start-up, duke krijuar mundësi për zhvillimin e projekteve inovative dhe rritjen e konkurrencës.			Gjendja bazë (20%)	Caku 2026 65%	Caku 2027 100%

Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit - (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1)Mbeshtetje financiare për zhvillimin e bizneseve Start-up dhe bizneset e grave	2026	150,000	Buxheti komunal	DZHE	MINT	Forcimin e barazisë gjinore në sektorin e biznesit.
	2027	300,000				
2)Organizmi i panairove dhe promovimi i bizneseve si dhe pjesëmarrja ne panairove	2026	40,000	Buxheti komunal	DZHE	MINT	Mundësi për rritjen e ekspozimit të produkteve
	2027	70,000				